

ESPERINOI i tē INTIES S'MADHE

e
M E S H A e SHËN VASIJIT

Evlojinéni i Vasilia

Ejani t'i faleni e t'i përmisemi Mbretit t'ënë Perëndi.

Ejani t'i faleni e t'i përmisemi Krishtit Perëndi e Mbreti i jinë.

Ejani t'i faleni e t'i përmisemi Atij vet, Krishtit Mbret e Perëndia jinë.

Ms.103

(lutiet çë thot Prifti qjeji tek
e Shtunia e Madhe)

Bekò,o shpirti jin t'en'Zonë !
O Zot,Perëndia i jim,sa je i Mathë !

155.

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

Je veshur ne nder e nadhöri, irre-thuar nga një nënt dritic.

Dora jote shtron kjielliën si një tendë, e ndërton dhonën t'ënde mbi ujërat.

Ti ke pör kjerr njekullat e jets mbi krahët e erës.

Ti je Aì çë bën frima öngjötë të 'Tij e shërbëtorë të 'Tij flaka zjari.

Aì çë stise jetën mbi themellet e 'saj sa nos të tundet mot pas noti.

Ti e pështrove ne okjeanin si ne një nënt, e ujërat kjëndruan mbi malet.

Si i kjährton, ata jikiön; si gjegjen zérin e bunbullimös, ata sduken.

U hipën mbi malet e u sdripën mbi fushat në atë vend çë Ti i dëftove.

I vure atireve një kufi çë ngë ka të shkojën; ngë ka t'priren prapa të pështrojën dheun.

Ti çë dërgon ^{në} përronje kronje, e ujërat do t'shkojën në nes të malevet.

Potisen gjithë shtazat e dheravet e gomarët të egërë i shuajën etien e 'tire.

Ndë 'ta zogat e kjielliës bëjën folét, ndër gurët ata këndojet.

Nga ndenja jote Ti i dërgon atireve shiun e ushkjenet dheu në penët e vepravet t'ote.

Ti Aì çë bën të rritet bari pör shtazat e barishtet t'i shërbejn njeriut.

Sa të ket bukën nga dheu e verën çë i gözòn zënërën.

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

Vajët çë i jep drittë fitirës s'tij e bukën çë fortëson zëmërën e njeriut.

Ti ushkjen drunjet e fushës e dëlli-njat e Libanit çë Ti mbolle.

Atié folén e 'tire bëjën zogat;sa pér sterku nredhat janë ndenja e 'tij.

Malet të lertë pér dhitë të egëra;gurët janë pështetie pér ljepruritë.

E bëre hënzion pér tò natur kjëroin e dielli njeh herën e të perënduarit 'tij.

Lëshon të më t'errëtitë e vien nata, e gjithë shtazat të egëra mbëjidhen ndë 'ta.

Të vegjitë e luanëvet ulurijën pér të rrëmbier, e Tij, o Perëndi, lipiën ushkjinin e 'tire.

ESPERINOI I TË INTIES H'MADHE

Lehet dielli e ata ngulen e bien e flön te gavërat e 'tire.

Atëherë del njeriu pér punën e 'tij e në mundin të 'tij njera çë ngriset .

Sa janë të nëdha veprat t'ote , o i Madh'in'Zot; të gjitha i ke bër ne dituri.

U mbëlua dheu ne kriesat t'ote. Sa dejti isht i nathë edhé i gjerë !

Lié janë shtërpinqë pa numer;shtazë të vogla bashkë ne të mëdha.

Atié shkojnë lundra;atié i vure të lozënje edhé balenën.

Gjithë ata shpresojën tek Ti t'i ja-pësh ushkjinin në kohë.

Kur ti ja jep , ata e mbëjedhiën; kur Ti sbill dorën, të gjithë tsiten ne dhuratën t'ende.

Kur Ti prier mbë nj'anë fakjien t'ende, trazonen; i ndsier frimën , e shuhën e köthehen te bota e 'tire.

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

Po kur Ti dörgon Shpirtin t'ënt, prapë krionen, e përtörin fakjien e dheut.

Kloft lëvdia e t'in'Zoti për gjithënonë; u gözofit in'Zot te veprat e 'tij.

Ai çë si vürrén dheun, ki dridhet: çö nget malet, e köta shtien kannua.

Do t'i këndonj t"in'Zoti për gjithë gjellön t'ime; do t'i nsal Peröndis njera çü rronj.

Kloft këndimi i jin i nirëpritur nga Aï; u gjithënonë do t'kérkonj gëminin t'in tek in'Zot.

Le të sduken tö mëkatruamitë nga fakjia e dheut, sa mos të jenë më të pa-ligjë. Beko, shpirti jin, t'ën'Zonë!

Dielli njeh herën c tö perënduarit tö 'tij. Lüshon tö errëtitë e vien nata.

Sa janë tö mëdja veprat t'ote, o i Madh'in'Zot, tö gjitha i ko bür ne dituri!

Lëvdi... aliluja(3)lëvdi Tij, o Peröndi. O shpresat e gjithë neve, paqe lëvdi!

E S P E R I N O I _ i _ të _ I N T I E S

(pas Litanis s'madhe këndonen nsalmet 140, 141, 129 e 116 me këndimet të vegantë)

Ψαλμ. PM'I40 Kúpue énénipaqxa ...

O Zot, u të thërrita Tij, gjegjënë; gjegjënë, o Zot. O Zot u të thërrita Tij, gjegjënë; vërt re zërit e luties t'ine si u Të, thërres Tij. Gjegjënë, o Zot.

Si livan le t'ngjipet përpara Teje lutia jime; të ngrëjturit e duarëvet t'ime flijë e mbrëmëshme. Gjegjënë, o Zot.

Vëj, o Zot, një ruajtie gojës t'ime e një derë rrëth buzëvet t'ime.

Mos lësh zëmbrën t'ime të lëshonet të folave të kekjia; të kérkonj'arsye përmëtë mbrojtur mëkatën t'ime.

Bashkë ne njerëzit çë bëjën të kekjen, ngë dua të përzihem me të sgledhurit e 'tire.

Më kjértoft njeriu i drejt ne lipisi; po kurr lieshit kriet t'imë vajtë e të mëkatruamit.

E S P E R I N O I i tē INTIES

Se endé lutia jime i pëlkjén atireve; nëpér gurë klenë gorronisur gjikëtarët tē 'tire.

Në janë tē zotët , le t'gjegjen fialët t'ime.

Si gruribuj botie janë hapur pér në dhe;ashtu' klenë shpiishur eshtrat t'anë pér në varre.

Pse sit t'imë janë gjithënonë tek Ti; tek Ti isht shpresa jime. Mos le shpirtin t'in tē shkret.

Ruajënë nga kurthi çë ngrëjtën pér nua; e nga skëndajit e atireve çë bë-jën paligjësi.

Ka t'bien te rrieta e 'tire tē mëkatruamitë vetë; u do t'kjëndronj mbë një anë njera çë shkonj.

Ψαλμ. PMA' I4I Φωνὴ μου πρὸς ...

Me zërin t'in u thërres t'ën'Zonë; me zërin t'in u i lutem.

Do t'i ndenj pérpara Atij lutien t'i-

E S P E R I N O I i tē INTIES

hjidhërinin t'in pérpara Atij do tē dëftonjë.

Si vete tue në lipsur frima, atëherë Ti ruan dhromin t'im.

Te udha pér tē çilën u ka t'shkonj, kanë fshehur kurth pér nus tē bie.

Tek e dërejta u veja tue vërrejtur, e ngë gjeta njeri tē më njihëj.

S'ka njeri ne kë tē jik e mosnjeri ka kujdes tē më shpëtonjë.

Tij tē thërrita, o i Madh'in'Zot, u thash: Ti je shpresa jime në dhe tē tē gjallëvet.

Mirrë'veshë , o Zot , lutien t'ime, se u përunja fort shumë.

Shpëtomë nga ata çë më ndjekiën, se ata janë më tē fortë se u .

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

Lironë nga fulakjia e shpirtit, sa mën-
dë të lëvdonjë émbrin t'ënt.

Do t'në presiën të dërejtítë njer çë
Ti ngë nö ke shpaguar.

Ψαλμ. PKO'I29 'En βαθέων ...

Nga vendet të humbët u Të thërrita
Tij,o i Madh'in'Zot; gjekj zërin t'im .

Le veshët t'atë të marriën 'veshë zë-
rin e luties t'ime.

Në Ti i vë·re paligjésivet t'ona,
kush mënd't'kjëndronjë? Vetëm tek Ti
isht ndëjésë.

Paj t'enbrit t'ënt të prita,o Zot, sh-
perti jit pret fialën t'ënde, shpirti
jin shpreson tek in'Zot.

Atëherë Sinedhri ... v.f. 146.

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

Çë kur bëh ndritçullë në mëngjes
njera çë ngriset; çë ngaruajtëja e
menatës le të shpresonjë Israeli tek
in'Zot.

I paligji Judhë çë te darka... f.146.

Se ka lipisi tek in'Zot e burì sh-
pérblimi, Aì do t'shpérblenjë Israelin
nga gjithë paligjésit e 'tija.

Judha tradhëtari ... f. 148

Ψαλμ. PIET'II6 Al'veñte τὸν Κύριον
Lëvdoni t'ën'Zonë o ju kombe të gji-
thë, lavdëronie gjithë popujitë.

Judha shërbëtori i rrem ... f.147

Se u shumësua lipisia e 'Tij mbi ne
e vërteta e 'tij mbetet për jetë të
jetëvet.

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

Kjenkji çë kishë paralajnëruar..f.148.

D h o k s a ...kje nin... *γχος ι). β'*

Vërtetani je , o Judhë,jinie nëpérkash
çë hajën Manën në shkretirë e pran
murmurisiën kundra Atij çë i ushkjej.

Me të ngënит edhé në gojë,flisiën kun-
dra Perëndis , të panjohëshnitë!

E ki i kekjë me bukën e kjiellit edhé
në gojë,zë e tradhëton Shpëtonjësin.

Oh,mendie e patsiturshme,oh,kudsim
mizor. Ai shet Kë e ushkjén;ai jep
morties të Zotin çë puth.

Vërteta i atireve ë bir i paligji
e me ata ai trazhgon sbierrien.

O i Madh'in'Zot lirona nga një të
këtillë mizori shpirrat t'anë,Ti kuj
ngë mëndë t'masiëm mirësin.

(*si prifti del nga Vima sa t'këndo-
një" Fos Ilarion...! vete tue thënë kë-
të parkalesi.:)*

Mbrëmanet,menatnet dhe për niesditë
Të lëvdojëm,Të bekojëm,Të falnderojëm
e Të lutemi , o i Zoti i gjithëve e Zot
i dashamirës.

Le t'vinjë përpara Teje si livan par-
kalesia jonë e mos le zëmbret t'ona të
bien në mendime të kekjë,po shpëtona
nga gjithë ata çë ndiekiën shpirrat
t'anë. Pse tek Ti,o i Madh'in'Zot,na
kemi sit t'anë e tek Ti na kemi shpre-
suar : mos na le në turp, o Perëndiai
jinë. Pse Tij të përket çëdë lëvdì,
nder e të përmisur Atit....

f o s i l a r ò n

O Dritë gaznore e lëvdì s'shejte të
Atit të pavdekshën,të kjiellit,të
shejt e të lum Iisu' Krisht !

Posa arrun te hera që isht e perëndon
dielli e shohiën dritën e mbrëmies,lëv-
dojëm Perëndin Atin,Birin e Shpirtin

E S P E R I N O I i t  INTIES

Shejt. Pse t  ka hj  t  jesh l  vduar
n  g d  her  e ne z re t  v jefshm ,
o i Biri i Per ndis g  jep gjell .
Prandai jeta t  l vdon !

profetsit

Ms.139 Shp tom  ; o i Madh'ind 
Zot , nga njeriu i lik;lirom  nga b
burri i shtr nb r.

T  cil t mendoj n t  kek
kjia te z n brat e 'tire;gjith  dit n
nejtoj n luftime.

nga libri i T  DALIT

XIX,10

Tha in'Zot Moiseut:sdripu e lajm r 
k tij populli e pastroi sot e nes r.

B ji t  laj n t  veshurat e t  jen 
gati tek e treta dit , p r q  tek e tre-
ta dit  ka t'sdripet in'Zot p r para
gjith  popullit mbi malin Sinai. Ka t 
v sh popullin n  kjark e ka t'i thuash:
ruhij nos hipij mbi malin a t'i ngini
gj . Kush t  ngas nj  malin,ka t'sos -
nj 

ESPERINOI I T  INTIES S'MADHE

vdekur. Mosnjera dor  ka t'e ngas nj :
ka t'jet a narr  ne gur  a kj lluar 
nga shigjeta:as njer  as shtaz  ka t 
rronj .

Kur gj m t e trumbet t e njekulla do
t'u ken sdukur nga mali, ahierna n nd 
t  ngjipen mbi malin.

E Moiseu u sdrip nga mali e vate n 
nes t'popullite i shejt roi; e lajt n
t  veshurat e 'tire. E ai i tha popul-
lit: t  jini gati,p r tri dit  mos kja-
sij gruaje.

E streksi se tek e treta dit , n  n n-
gjes, u ndiej t n gj na e shkreptina
e nj  njekull  e d ndur  sip r malit
SINAI e z ri trumbetie ish  shum'i
fort, akj  se gjith  populli g  ish 
te fusha u tr mp. E ndsori Moiseu po-
pullin sa t  p rpikj j t' n'Zon  jash-
ta tend s e kj ndruan te k nb t e na-
lit. Gjith  mali i Sinait shtij kannua
p r q  u kish  sdripur in'Zot mb  't 
n  ziarr. Kammoi hipej si ai i nj i fur-
ri e gjith  populli  m ndej fort. Tin-
guj t  i trumbet vet vej n t ue u b r
n  t  forta tep r. Moiseu flis j e in 
Zot i p orgjegjej me z  .

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

Ms.58 Shpëtomë nga armikjët t'imi

Liromë nga ata çë bëjën të
kekjen.

nga libri i Jobit 38,1-21
42,1-5.

Tha in'Zot nëpër stuhi e mjekulla:
kush ë ki çë fsheh këshillin e 'tij
nga U,çë mban fialët te zëmbra e 'tij
e mendon të i fshehënë ngak U ?

Rrethò si burrë ijët t'ote se u
ka të t'pienj e ti ka t'më përgjegjesh.
Teku ishe ti kur u stisia jetën. Thu-
ajmë,në ke akjë ndëlgim. Kush tsaktoi
kufit ? E di ? A kush i shturi tërkuz-
zën mbi atë ? Kush i stisi themelet,
kush vuri gurin angonie? Kur len ijë-
zit me zë të mathë më lëvduan ëngjëji-
të t'imi. U mbilla dejtin me dier kur
ai derdhej jashta si nga gjëri i mëmës.
U i vura mjekullat si e veshurë e një
të errët të dëndur e rrethoi.

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

I yura edhë kufit tue e rrrethuar me
dier e me prangë. E i thash atij:ka
t'vishë njera këtu,po ngë ka t'shkoshë
e këtu ka t'çahen valat t'ote.

Çë kur rron ke urdhuruar agimit,i
'ftove vendin e 'tij yllit i menatës
sa t'zaptoj kandet e dheut e t'i pér-
zëj të kekjitë ?

A kleve ti çë,të marrët botën bëre
një gjé të gjallë e e vure mbi dheun
tue i dhënë fialën?Ndoshta kleve ti çë
i ndsore dritën të likjëvet e drëmove
krahun krielartëvet? U sdripe ti te
burimi i dejtit e jetse në fund të
abissit? Diert e vdekjies u sbillën
tij për dre e dereruesitë e Adhit u
shkundën kur të pan tij? Njeh ti gjithë
të ndejturit e dheut ? Flit në ti
njeh gjithë këtë. Te qili dhe rri dri-
ta,çili ë vendi i errësirës ?

171.

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

Në ti më përsiellie te kufit e 'tire, në ti njihie dhromet e 'tire . Po ka t'i njohësh,përçë ti leve ahierna. Nëmëri i vietçëvet t'atë isht i mathë! XLII,1-5. Ahierna Jobi mori e ju përgjekjë t'in'Zoti: U di se Ti mëndë të bësh gjithkjishë.Mosgjë isht të pamën-dëshëm pér Tij. E kush mëndë të t'fshe-hënë Tij çëdo mendim të vet?

Kush kursen fialët e ndëlgon t'i fshehënë Tij? Kush do të më thet muar shërbise çë ngë dija;shërbise të mëdha e të famasëshme çë ngë njihia.

Gjegjëmë , o i Madh'in'Zot,se u dua të t'flas,dua të t'pienj gjagjë e Ti mësomë. Më para të gjegji veshi jim;nani edhe siu jim të pa.

nga libri i Isaïs
50,4-11.

In'Zot më dha një gluhe të dijshmi, sa u të di kur duhet të flas.

172.

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

Ai më sgjon nga menatë;më nget veshët sa u të gjegjem. Më sbilli veshët e u ngë: kundrështova,ngë u shtura prapa.

Dhash krahët sa t'më rrahiën;fakjien t'ime të më jipiën shplaka. Ngë fsheha fakjien t'ime nga turpi i pushtimëvet.

Po in'Zot,in'Zot u bë ndihma jime; prandai vura fakjien t'ime si gur i that e di se ngë ka të ngukjem pér turp,pse ai çë më jep likjë ë nd'anëzë meje. Kush ka t'më dënonjë? le t'më vinjë kundra. Kush ka t'më gjikonjë? le t'më kjaset. Shi' in'Zot , in'Zot ka t'më ndihënë. Kush ka t'më bënë like? Shi',gjithë ju si një e veshurë ka t'vietronij e kopitsa ka t'ju gri-një. Kush ndër ju i trëmbet t'in'Zoti?

Le të marrënë veshë Ai zërin e shërbëtorit t'tij. Ju çë jini ndë të errëtitë e ngë kini drítë,të kini besim te émbri i t'in'Zoti e mbahij fort tek

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

in'Zot. Shi', gjithë ju çë dhizënizjarrin e veni tue jetsur rreth e rrrotull me shigjeta zjarri, jitsëni me dritën e zjarrit t'ej e të flakës çë dhizet. Nëpër mua do t'ju vijën këto:do t'ngulij në lipë.

*Me Trisajin më para se pistulla
zë Mesha e shën Vasijit*

Përcë gjindet tërbonen e popujitë të vën në mendë të kota?

Përzihen bashkë të Parët sa të vën ballë me Perëndin e me Krishtin e 'Tij ?

I Kor. XI,23-32

Vëllézér, atë çë dsura nga in'Zot u ju e thom juve:se Zoti Krisht te nata çë kle prëdhënë, mori bukën e , tue

174.

ESPERINOI T TË INTIES S'MADHE

falur nderies , e çajti e tha: mi r - rëni , han i : k i ë K u r m i i j i m , çë për ju çahet :këtë bëni sa t'më kujtoni. Kështu edhé kjelkjin, pas të ngrëni darkën tue thënë: k i k j e l k j è i s h t d h i a t a e re t e g j a k u i j i m :këtë bëni nga herë çë t'e pini në kujtim t'im. Vërteta sa herë të hani këtë bukë e të pini këtë verë, do t'lajmëroni vdekjen e t'in'Zoti njera kur të vinjë pameta. Prandai kush të hannjë këtë bukë e të pinjë kjelkjin e t'in'Zoti pa klënë i vëjéfshëm, do të ftesënëjë gjakun e kurmin e t'inë Zoti. Prandai nganjeri le të vërenjë më para në isht i mirë e prale t'hanjë nga këjo bukë e le të pinjë nga ki kjelkjë. Përcë kush ha e pi pa klënë i vëjéfshim, ha e pi dënimin e 'tij, pse s'ka dalluar Kurmin e t'in'Zoti. Prandai shumë ndër ju janë të likështë e sëmurë e disa flën.

Në na gjikoneshëm mirë vet vetiu, ngë ki't'ishëm dënuar; gjikuarë nga

175.

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

in'Zot,ka t'jeni munduar sa mos të jemi dëhuar bashkë me jetën.

I lum ai njeri çë kujdeset pér të vapëkun; in'Zot ka t'e lironjë në ditë e kekjie.

Ai çë ha bukët t'ime ngrëjtë thëmbrën kundra meje; po Ti, o Zot, kijmë lipisi e ngremë u do t'ja shpaguanj atirewe.

V a n g j e j i

Mt.26,1-20; Gv.13,3-17; Mt.26,21-39;
Lc.22,43-45; Mt.26,40-75; 27,1-2.

In'Zot i tha dsönësëvet e 'tij: Ju e dini se këtu e di ditë ka t'jenë Pashkët e i Biri i njeriut ka t'jet dhënë në duar sa t'e vën n'krikjë.

Atëherë u mbëjodhën të Parët e priftravet e shkruesitë e plekjët e popullit te trëmeja e Kriepriftit çë i thoshiën Kajafë e mbajtën ndër 'ta këshill

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

sa t'e zëjën Iisuin me gënjam e sa t'e vrisiën.

E thoshiën: jo te dita e festës, nos të bënët trazim te populli. E posa ndodhej Iisui në Betanë te shpia e Simonit, të sgjeburit, ju kjas një grua çë kishë një rrrogjé alabastri e plotë me vaj érësh të shtrejtë shumë e jaderdhi mbi kriet Iisuit çë ishë vënë te triesa. E si pan kështu dsënësit e 'tij u mbërijtën tue thënë: përcë këta të sbierrë? se këta vaj érësh mëndë të shitej shum fort e t'jipej të vapëkjëvet.

Por Iisui si e gjegji i tha atireve: përcë e varsni këtë grua? Ajo më ka bër mua një veprë të mirë. Se të vapëkjítë i kini gjithë herët me ju, Mua pra ngë më kini gjithë herët. Se tue shtur ajo këta vaj érësh mbi kurmin t'im, ajo e bë skur pér të varrzuar Mua. Vërtetazë U ju thom, se atié ku të ligjëronet te gjithëjeta ki vangjej, atié ka të flitet e të thuhet atë çë bëri ajo pér kujtim të 'saj.

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

Ahierna njeri nga dimbödhietitë, çë thërritej Judhë Iskariot, mori e vate te të Parët e priftravet e i tha atire: çë do t'më jipënje u ju e jap te duart Atë? E ata kjëndruan t'i jipi-ën tridhietë dënarárë të 'rrggjendë.

E çë ahierna ai vej tue kërkuar viershin sa t'ja jipëj te duart.

Tek e para ditë e të pangridhuravet u kjasën dsënësit tek Iisui e i thanë Atij:ku do ti se të shtrojëm triesën sa të ham Pashkët? Ai i tha: étsëni te kxiteti tek aktsili e thonii: Mieshtri thot: hera jime isht nd'anëzë: tek ti U dua t'bënëjë Pashkët me dsënësit t'imë.

E bën dsënësit ashtu si i urdhuroi Iisui e shtruan për pashkët. E si u ngris, ish'Ai vënë te triesa bashkë me dimbödhietitë.

Posa e dij Iisui se gjithëkjish i kish' Atij dhënë i Jati në duar e se Ai dolli nga Perëndia e te Perëndia kishë të vej, u ngre nga triesa e darkës, e la të veshurat e 'tija, e mori një mësallë e e vu të mesi.

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

Pran mori e shtu ujë te lëgjeni e zutë laj kömbët e dsënësëvet e t'ja fshij me mësallën çë kishë shtrënguarë te mesi. Vien te Simon Pietri e ki i thot Iisuit: Ti mua më lan kömbët? U përgjekjë Iisui e i tha: Atë çë U jam e bënji NANÀ NGË E DI, po ke t'e ndëlgoshë pran. I thot Atij Pietri: Jo, për jetë s'ke të m'i lash kömbët kurr Ti mua. Ju përgjekjë Iisui: në mos të lafsha U Tij, ti s'ke piesë me mua. I thot Simon Pietri: Zot, po jo vetëm kömbët mua, se edhë duart e kriet.

I thot Iisui: atij çë kle lar ngë i duhet t'jerë veç se të lanjë kömbët, se isht gjith'i pastër. E ju jini të pastrë, po jo të gjithë. Përsé Ai e dij kush kishë me përdhënë Atë, andai tha: jo të gjithë ju jini të pastrë.

Posa pran i kishë lar kömbët atire e kishë narrë të veshurat e 'tija, u vu pameta te triesa e i tha atire: Ju

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

e ndëlgoni atë çë bëra U juve ?

Ju më thërrini Mieshtér e Zot e thoni drekjë, se i jam. Në andai ju lajta këmbët, U Zoti e Mieshtëri, edhé ju kini détirë të lani këmbët njeri t'ja trit. Se u ju lash shembërë juve, sa ashtu si U ju bëra juve, edhé ju të bëni. Vërteta, vërteta U ju thom:ngë isht shërbëtar më i mathë se i zoti i 'tij, as një: i dërguam më i math se Aì çë e dërgoi. Në këto ju i dini, lumët ju do t'jini në i bëfshit.

E si sih'e hajën, Aì tha: vërteta U ju e thom, se një ngak ju ka me përdhënë Mua. E gjithë të helmuamë ata zun fill t'i thëshiën një nga një: Zot, mos jam u ? Aì u përgjegjë e i tha: aì çë njom dorën te tajuri me Mua, ki ka me përdhënë Mua. I Biri i njeriut isht e vete, ashtu si kle shkruar mbi Atë. Vaje atij njeriu nga kush i Biri i njeriut

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

vien përdhënë. Ishë mirë për atë njeri mos të kishë ler. Po Judha, i çili kishë

me përdhënë Iisuin, u përgjekjë e tha : mos jam u , o Mieshtér? E Iisui i thot: ti e the.

E ashtu si ish'e hajën mori Iisui bukën, e bekoi, e çajti e ja jipëj dsënësëvet tue thënë: Mirräni e hani:KI Ë KURMI I JIM. E mori kjelkjin, dha hir-Perëndis-e ja dha atireve tue thënë: Pini nga ki të gjithë:SE KI Ë GJAKU I JIM, i dhiatës s're, çë ka të derdhet për shumë vetë për ndëjésen e mëkatëvet.

U ju thom edhé se çë nani u ngë ka t'pi më nga këjo pemë e dhris njera tek ajo ditë kur t'e pi me ju të ri te rregjëria e Tatës t'im.

E posa kënduan lëvdit e Perëndis, duallën e vanë te mali i ullinjëvet.

Atëherë i thot atireve Iisui: te gji-

thë ju sonte te köjo natë ka t'kini skëndall mbi Mua, se kle shkruar: "Del-
merit ka t'ja kërses e delet e mën-
drës kanë të shprishen! Kur pra U të
ngjallëm, ka t'ju vete përpara juve në
Galilé. E Pietri ju përgjekjë e i
tha:në edhé të gjithë marrëshin skën-
dah mbi Tij, u s'kam të marrë kurr
skëndah. I tha atij Iisui:vërteta të
thom se sonte natën, më para se të kën-
donjë gjeli, ti mua tri herë ka të më
mohosh. I thot Pietri: në i dukëshit
edhé se u të vdes bashkë me Tij, u
s'dua të të mohonj Tij. Kështu të njëj-
të thanë edhé të gjithë dsënësit.

Atëherë vien Iisui bashkë me ata mbë
një vend çë i thonë Gjetseman, e i thot
dsënësëvet: ju rrini këtu se U vete kë-
tié të parkales. Mori ne 'të Pietrin
e di bijët e Zebedheut e zu të hjidhë-
ronej e të helnonej. Atëherë i thot

atireve: shpirti jim isht në helm të
mathë sa skur vdes; mbetni këtu e rri-
ni sgjuarë bashkë me Mua. E vate pakë
në atei e ra me fakjie përmist tue
parkalesur e tue thënë: Tata jim, në
mënd't'jet, le t'shkonjë ngak U ki
kjelkjë; pran jo si dua U, po si të
duash Ti. E atij ju dëftua një ëngjeh
nga kjiellia e i jipëj fukji. E se
ishë në agonì Aì më shumë parkalesëj.
E diërsët e 'tija u bën si pika gja-
ku çë i rridhiën mbi dheun. E u ngre
nga parkalesia e vate te dsënësit e i
gjen të kjëlluamë nga helmi, çë flëjën.
e i thot Pietrit: kështu ju ngë ja bët
të rrijët sgjuarë një orë bashkë me
Mua? Rrini sgjuarë e parkalesni, mos
të hini ndë ngarie: shpirti e me-hir,
po mishët e të likësht. E pameta vate
nj'atrë herë të parkalesëj tue thënë:
Tata jim, në kloft se ngë mëndë të
shkonjë ngak U ki kjelkjë, të mos e pi,
po u bëft vullimi i jit. E jerdhi e
i gjeti pameta çë flëjën: se sit e
'tire ishën të mëshuanë gjumi.

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

E i la e vate paneta të parkalesëj të tretën herë tue thënë po ato fialë.

Ahierna vien te dsënësit e i thot atireve:po flëni pra, edhé prëhij:shi' se u kjas hera e i Biri i njeriut isht e i jipet te duart të mëkatruamëvet.

Ngrëhij e vemi:se isht nd'anëzë ai çë ka me përdhënë mua. E si edhé ish' e flisëj,shi' Judha , një nga dimbëdhietitë, se jerdhi,e bashkë me atë një lusmë e madhe me shpatë e messhko-pe,dërguarë ngatë Parët e priftravet e nga plekjët e popullit. Ai çë e kishë përdhënë Iisuin,i kishë dhënë një shenk atireve,tue thënë: Aì çë u puthësha,isht aï:zenie. E shpejt ju kjas Iisuit e i tha: Të falem,o Mieshtër, e E puthi . E Iisui i tha atij: Mik, pérçë jerdhe ? Ahierna u kjasën e i vun duart sipër mbi Iisuin e e zun.

E shi' një nga ata çë ishën bashkë me Iisuin , ndejti dorën,holkji shpatën e 'tij e.i ra shërbëtorit e kriepriftit e i preu veshin . Atë herë i

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

thot atij Iisui:vërecshpatën t'ënde te vendi i 'saj:se gjithë ata çë marriën shpatën,në shpatë do t'sosiën. Mos të duket tij se U nanì ngë mëndë të parkales Tatën t'in: e Ai të në vënjen përpara më shumë se dimbëdhietë ushtëri ëngjëjish ? Po si ka t'mharonen të Shkruamet,se kështu i duhet të jet?

Tek ajo herë Iisui i tha gjindes:duallët skur ki't'vejët mbi kusarë me shpatë e ne shkope,të në zëjët: nga ditë me ju rrıja ujur tue mësuar te faltorëja , e ju ngë më kini zënë. Po gjithë këto jan'e streksiën sa t'mbaronen të Shkruamet e Profetravet. Atë herë gjithë dsënësit e lanë e jikën.

Ata posa çë e zun Iusuin,e kjellën te Kajafa,krieprifti,teku shkruesit e plekjët u kishën mbëjedhur.

Pietri i vej prapa së largu njera te trëmeja e Kriepriftit:e si hiri brënda, muar të ujej bashkë me shërbëtorët sa të vërrej si sosëj. Të Parët e pri-ftravet e plekjët e gjithë ajo mbële-dhie kërkojën deshni të rrëne kundra

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

Iisuit, sa t'e vrisiën e ngë i gjetën.
 Edhé megjithëse jerdhën pörpara disa
 deshnorë të rremë, ngë i gjetën; pran u
 kjasën di të rremë e thanë: Ki ka thënë
 se " U mëndë t'gorromis Faltoren e
 Perëndis e t'e stis te tri ditë. U ngre
 Krieprifti e i tha: Iisuit:ti nosgjë
 përgjegjemi atë çë kötu thonë kundra
 Tij ? E Iisui rrrij pa folë. E Kriepri-
 fti u përgjegjë e i tha: të thérres
 ne bë pér Perëndin të gjallë, të na
 thuash nö Ti je Krishti i Biri i Perën-
 dis. I thot Iisui: Ti e ke thënë: po
 edhé U të thom se çë nani ka të shihë-
 ni të Birin e njeriut, ujur tek e dërej-
 ta e pushteties s'Perëndis edhé të vi-
 një nbi njekullat e kjielliës.
 Atë herë Krieprift shkJORRI pethkat e
 'tija tue thënëse shtu llastimë: çë e
 duan të kemi martir? Shi' nani ju e
 kini gjegjur llastimën e 'tij. Çë ju
 duket juve ? E ata u përgjegjën: ai
 isht fajtuar pér vdekjie. Atëherë i
 pushtijtën në fakjie e i ran me grush-
 te e i dhanë shplaka, tue thënë: Ti, Krisht,

186.

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

thuajna si profetë, kush t'e kërsiti?
 E Pietri rrrij jashta te trëmeja; e ju
 kjas atij një vajzë tue thënë: Edhé ti
 ishe bashkë me Iisuin, Galileun. Aì e
 mohoi, pörpara gjithëve, tue thënë. U ngë
 di çë ti je thua. E si mori të dilëj
 te dera e pa nj'atrë e i tha atireve a-
 të: edhé ki ishë bashkë me Iisuin, Naza-
 renin. E aì pameta tue bër bë e mohoi.
 U ngë e njoh atë burrë. Mbi tsa pakë
 ata pörpara u kjasën e i thanë Pietrit:
 vërteta edhé ti je një nga ata: se edhé
 të folët t'atë të bën të njihesh.

Ahierna aì zu të nëmëj, të bëj be e rrë-
 fé: se u ngë e njoh atë njeri. E te gji-
 thë një herë gjeli këndoi.

E u kujtua Pietri ka fiala e Iisuit,
 çë i kishë thënë: "Se më para se të kën-
 donjë gjeli, ti mua tri herë ke të më
 mohosh. E dolli jashta e klajti me helm.

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

Menatnet pra mbaitin këshill gjithë
të Parët e priftravet e Plekjtë e po-
pullit kundra Iisuit, sa mënt'vdisëj.
E lidhur e kjellën e e lanë te duart
e Pontsj-Pilatit Kjivertarit.

PÄRKALESI TË VEÇANTE të MESHËS E SHËN VASIJIT

l u t i a për Katekumenjtë

O I MADH'IN'ZOT Perëndia jinë çë
jes në kjielliat e ke siun mbi veprat
t'ona, vërrëj shërbëtorët t'atë kate-
kumenjë çë ujën kriet e 'tire përpara
Teje e jipi atireve një sgjedhë e leh-
të; bëji piesë të ndermë të Klischës
t'ënde të shejte; bëji të mirë për të
lajturit e rilindies, për ndëjesën e më-
katëvet e për të veshurën e paprishë-
ris sa ata të T'njohiën Tij i vërteti

Perëndia jinë .

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

Sú Kúprie matrédeuzas ëmu...
Ti, o i Madh'in'Zot, na dëston këtë mi-

ster të mathë të shëndetës. Ti neve
shërbëtorë t'atë të pavëjéfshmë e të
mjerë na bëre të mirë të shërbëjëm te
Therorëja jote e shejte. Ti me fukjin
e Shpirtit Shejt bëj-na të zotë të kë-
saj diakërie sa, tue rrijtur pa gji-
kim përpara lëvdis s'ate e shejte të
t'bëjëm flijë lëvdimi. Pse Ti je çë ve-
pron gjithkjish te gjithkjishë.

Ëna të jet e mirëpriturë flija jonë
dhe e pranuarë për mëkatët t'ona e për
të paditurat e popullit.

'O Θεός, δέ επισινεφάμενος ...

O i madh'in'Zot çë me lipisi e mirësi
vërrén ujtësin t'enë; çë neve të mjerë
të mëkatruamë, të pavëjéfshmë shërbëtorë
t'atë na vure përpara të shejtes lëvdi
s'ate të priftërojëm tek e shejta The-

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

rōre jote, Ti na fortēsò me fukjin e Shpirtit Shejt t'ënt te këjò diakëri e, si të sbilliëm gojën, jipëna fialët çë i duhen sa të thérresiën dhuratën e Shpirtit Shejt mbi dhuretit çë do t'jenë parakjiturë.

Kúpte, ó Thëòç ñuñv ...

O i Madh'in'Zot Perëndia jinë çë na bëre e na prïre te këjò gjellë; çë na dëftove udhët e shëndetës; çë na fale të sbëluarit e misterëvet të kjielli-ës; Ti çë na vure te këjò diakëri me fukjin e Shpirtit Shejt Të u dukëshit mirë se na të jemi shërbëtorët e Dhiatës t'ënde të re, mbarështuesë e të shejtravet Misterë; pranò paj të madhes lippisi s'ate se na të kjasemi Therores t'ënde të shejte e të bënemi të mirë 190.

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

të T'faliém këtë flijim të mendgëm e të pàpërgjakshëm pér mëkatët t'ona e pér të paditurat e popullit.

Ti tue e narrë ne-hir mbi shejten Therore kjellishte pér të mirën erë, neve na dhëfshit këthyer hirthin të perëndishëm të Shpirtit Shejt.

Shtié siun t'ënt mbi ne, o Perëndi, e vërrej këtë latrì jonë e mirre ne-hir si more dhuretit e Abelit, flijët e Noeut, olokaustet e Abramit, shërbimet të shejtë të Moiseut e të Aaronit, Ilijët pakjie të Samuelit.

Si prite mirë këtë latrì të vërtetë nga Apostojitë shejtë, edhé prit mirë këto dhureti nga duart t'ona e neve të mëkatruamë, paj të butësis s'ate, o i Madh'in'Zot; sa, bërë të mirë të priftërojën të pakjärtuashmë te shejta Therore jote, të gjegjën rrogën e kujdestarëvet të besnë e të urtë te dita e dreruashme e shpërblimit t'ënt të döréjt.

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

'O ūv , Δέσποτα , Kúpιε , Θεέ...

O Zot çë je të klénit,Zot e Perëndì i gjithëmëndën e i proskjinisur,mirë isht e dërëjt e i duhëshëm Madhëris e Lëvdës s'atese na të T'bekojëm,të T'këndojojëm,të T'innojëm,të T'permise mi,të T'falnderojëm e të T'lëvdojëm Tij çë je vërteta i vetëmi Perëndì e të T'faliëm ne zëmërë c grijturë tue dhëmbur e ne shpirt ujtësie këtë la tri t'önë të mendçme.

Pse Ti na fale të njohurit e Vërteties t'ende . E kush isht i mirë të rrëfienjë pushtetiet t'ote? Kush të bënjo të ndihen gjithë lëvdit t'ote a të ligjëronjë në çëdë kohë famasmët t'ote? O i Zoti i gjithësis,Zoti i kji-elliës e i dheut, e çëdë kriesie e dukurë dhe e padukurë,Ti çë ujur mbi t thron lëvdie vërren abisset,i pa-zënë fill,i pa-parshëm,i pandëlguashëm, i papërshkruashëm, i pandërruashëm,ATI i Zotit t'ënë Iisu' Krishti,i madhi Perëndì e Shpëtuesi i shpresës t'ënë,

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

çë isht fitira e mirësis s'ate,sidçili krejt i njëshën me shembörën e 'tij;çë dëftove në Vetë fitirën e Atit,Fialë e gjallë Perëndì i vërtetë, Dieja mö para se jetët,gjella,shejtërimi,fukjia,drita e vërtetë nga e gjala u dëftua Shpirti i Shejt,dhurata e përbirënarries,pengu i trazhgimit të ardhshëm,fillimi i jetëvet të mira,fukjia gjellëbërese,kroi i shejtërinit nga i çili tue marrë fukji çëdë kriesë e mendçme e shpirtullore Të përmiset e Tij të fal lëvdërim të përjetshëm se të gjithë janë shërbëtorë t'atë. Se Tij këndojojn Ëngjëjité,Arkëngjëjité,Thronet,Zotërit,Parësit,Pushtetet,Fukjit e Serafintë me shumë sira e Tij të rrin përpara e rrëth,Hjeruvintë me gjashtë fletë çenjéri e ne di pështrojën fakjien e ne di kömbët e ne t'jera di fluturojën tue thënë njeri jetrit me thirna të paprera,lëvdërine të pashuara e kënkën e mundësis tue kënduar,tue uluritur,tue thërritur,tue thënë:

Mëtë tòutow tòw mognaplòw...

Me këto fukji të lume, o i Zot njeri-dashës edhé na të mëkatruamë thérresi-ëm e thomi: Ti je i Shejt me të vërte-të e gjith'i shejt e s'mëndë t'matet madhëria e shejtëris s'ate; i shejt te gjithë veprat t'ote, pse në dërejtësi e gjikim Ti të gjitha i ke bër pér ne.

Se kur gjeshe njeriun tue marrë botën nga dheu e e nderove tue i dhënë fitirën t'ënde, e vure te parraisi i dëfri-mit tue i taksur atij pavdekjian e tra-zhgimin e të miravet të pasosme, në ai ruaj urdhurimet t'atë.. Po si ai ngë të mori 'veshë Tij, Perëndi i vërtet që e bëre e u la t'e gënjej gjalpëri e të vdisëj te mëkatët e 'tij, e përzure me gjikim të vërtetë, o Perëndi, nga Parraisi te këjo jetë e e prore te dheu nga i çili kishë klënë marrë tue i përgatitur atij shpëtim nga rilindia te Krishti i jit. Ngë e rreshte pér jetë kriesën t'ënde që ti kishe bër, përsé Ti je i mirë; as harrove të bëmen e du-arëvet t'ote, po shumë herë erdhe e e

pe me shumë vjershe paj të dashamirësis e lipisis s'ate. Dërgove profetrat, bëre famasmë me shejtrat t'atë të cilët nga jini të kanë pëlqjier; na fole me gojën e profetravet shërbëtorë t'a-të tue na paralajmëruar shëndetën të ardhshme e na dhe një ligjë pér ndihmë e na vëre ëngjëj të na ruajën. Kur pran u mbaruan kjeronjet na fole me Birin t'ënt pr'anë të cilët kishe bër jetët; i çili tue klënë pérthimi i lëvdës e mresa e të klënitet t'ënt-çë kjell gjithkjish me fukjìn e fialës s'tijngë ndiejti, si një të rrëmbier këta të klënë të njëjtë me Perëndin e At, po tue klënë Perëndi më para se jetët, u dëftua mbi dhet e rroi në mes njerëzëvet, mori mishë nga shejta Virgjërë e u bë mosgjë tue marrë fitirën e shërbëtorit e u duk e u bë shok jini me kurmin e ujtësis t'ënë sa t'na bëj sho-

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

kë të 'Tij në fitirë të lëvdis s'tij. Porsanith pér njeriun mëkata hiri tejeta, i pëlkieu Birit t'ënt të vetmitler- çë ö në gji t'ënt Perëndi e At - të lehej nga gruaja,nga Povirgjëra e shën Mëri Mëma e t'in'Zotie u vu pérposh ligjës sa të mundëj mëkatën te mis shët e 'Tij,sa gjithë ata çë kanë vdekur në Adham të ngjallen tek Aì,te Krishti i jit , e tue rruar te këjò jetë na dha urdhurime shëndetie e na liroi nga gënjeshtra e idhujvet e na kjelli te të njohurit Tij Perëndi e At i vërtetë,tue stisur pör 'të një popul i 'tiji,një priftëri mbretërore,një komb i shejt; e tue e pastruar me ujë të shejtëruam me Shpirt të Shejt u dha si shpërblim i jinë nga vdekjia të çilös na kishëm klönë shitur me mëkatën e tue u sdripur pr'anë të Krikjies në Adhë,sa t'mbushëj me fukjin e 'tij gji-

ESPERINOI I TË INTIESS'MADHE

kjish,sigidhi dhëmbiet e vdekjies e i ngjallur të tretën ditë,i sbilli udhën e ngjallies sö vdekurish gjithë njerëzëvet,se ngë ishë e mundurë se Krietari i gjellës ki't'ishë mbajtur nga prishëria-e Aì u bë i pari i atireve çë u kishën kjëlluar, i parillér nga të vdekurit sà mbë gjithkjish t'ishë i Pari. E ngjipur në kjiell u uj tek e dërejta e Madhëris s'ate te më të lartitë kjiej.

Aì ka t'vinjë përsëri sa t'i japënë nga-njeriu pas vepravet e 'tij,po nёve na la köta kuftime të pesimevet e 'Tij si duan urdhurimet e 'Tij.

Si Aì , vet vetiu , ish'e nisej pér vdekjen e 'Tij gjellëbërese e gjithë monë pör të kujuar,te nata kur u dha pér gjellën e jetës,tue marrë bukën te duart e 'tija të shejta të dëlira e tue e falur Tij At e Perëndi

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

e tue falnderuar,bekuar,shejtëruar e
çar ja dha apostojvet e 'Tij të shej-
të tue thënë MIRRËNI,HANI

Toῦτο ποιεῖτε εἰς τὴν ἐμὴν
ἀνάπινησιν.

Bëni këtë sa të më kujtoni. Sa herë
me të vërtetë do t'hani këtë bukë e
të pini këtë kjelkjë do t'lajmëroni
vdekjian t'ime e të ligjëroni të ngja-
llurit t'imë.

Prandai tue kujtar edhé na pesimet
shpëtimtarë të 'Tij,krikjien gjellë-
bëreme,varrin triditëshëm e të ngjal-
lurit së vdekurish e të ngjipurit në
kjiell e thronin tek e dërejta jote ,
At Perëndi , e të lëvduashmit e të
dreruashmit të jardhur t'Tij

Na Tij të faliëm t'otet ...

198.

Διὰ τοῦτο,Δέσποτα Πανάγιε ...

Prandai , o Zot gjith'i shejt,edhé na
të mëkatruamë të pavëjéfshmë shërbëto-
rë t'atë,çë kemi klënë bër të mirë të
shërbejëm Theroren t'ende të shejte,jo
për të dërëjtat t'ona-se mosgjë të mirë
kemi bër na mbë jetë- po paj të lipisi-
vet e përdjesavet t'ote çë ke derdhur
me burë mbi ne,marriëm zëmërë e kjase-
mi Therores s'ate e shejte e tue falur
fitirat e Kurmit t'shejt e t'gjakur të
Krishtit t'ënt,të lusiëm,të parkalesiën,
o i Shejt i Shejtravet,me pëlqimin e
mirësis s'ate të vinjë Shpirti i jit i
shejt mbi ne e mbi këto dhureti të pa-
ravune e t'i bekonjë e t'i shejtëronjë
e t'i dëftonjë

këtë bukë të vetin e të çmuamin KURM
të t'in'Zoti e Perëndi e Shpëtuesi jinë
Iisu' Krishti

e këtë kjelkjë të vetin,të çmuamin
GJAK të t'in'Zoti e Perëndi e Shpëtue-
si jinë Iisu' Krishti çë kle derdhur
për gjellën e jetës.

199.

ESPERINOI I TË INTIES S'MADHE

‘Huiç ësë pánntac . . .

Edhé neve të gjithë çë marriëm piesë te një bukë e te një kjelkjë bashkona njerin me t'jetrin te bashkimi i Shpirtit Shejt e mosnjérin ngak na të lësh të kungonet me shejtin Kurm e Gjak të Krishtit t'ënt pér gjikim a pér dënim: sa na të gjejën lipisi e hir bashkë me gjithë shejtrat çë moti Tij pëlqjieshmë Propatorë, atëra, patriarkëra, apostoj, ligjironjësë, deshmorë, rrëfénjësë, mësuesë e nga shpirt çë vdkjë me besën .

në vend të "Axion estin"-it këndonet:

‘Epì soi χαίρει, Κεχαριτωμένη . . .

E Ëngjëjvet mbledhia, e njerëzëvet jinia, o Faltore e hjynushme e Parrais i mendçëm, i Virgjëreshavet lëvdim nga e çila in'Zot mori kurme Dialë u bë Aì i paramotshmi Perëndia jinë. Se brënda Teje thronin e 'Tij vuri e gjirin t'ënt e bëri më të gjerë se kjielliat.

Mbi Tij gjzonet, o e Hir-plota, jeta e tërë. Lëvdì Tij.

ESPERINOI E MESHA E T'INTIES

Toü ἀγίου Ἰωάννου τοῦ προφήτου
naç βαπτιστοῦ . . .

Pér shën Janin Profet, Paradhrom e Pagëzor, pér të lëvduashmit shejtra Apostoq, pér shejtrat çë sot përmendiëm e pér gjithë shejtrat t'atë paj të cilëvet, Ti, o Perëndì, i madh'in'Zot, kijnasim.

E kujtò gjithë ata çë u kjëlluan gjumi me shpresën e të ngjallurit te gjella e pasosme. Le t'prohen atié ku i ruan drita e fakjies s'ate.

Edhé Të parkalesiën: kujtò, o i Madh'inë Zot, Klishën shejte t'ënde katholike e apostolike e shprishurë te gjithë anët e Botës e jipi pakjen se Ti e bleve me gjakun t'ënt të shejt. Jipi kjëndresën kësaj shpie e shejte njera çë sosjeta. Kujtou pér ata çë të faliën këtò dhureti e pér kë ata t'e prun.

Kujtou pér ata çë bien klishëvet t'o te të shejte pemët e 'tire e ndihiën e sbukurojën Klishët t'ote e pér gjithë ata çë kanë kujdes të vapëkjëvet; pri-ri atireve kjosmët e hirevet t'atë

ESPERINOI E MESHA E T'INTIES s'MADHE

kjellishte; në vend të të miravet e dheut jipi të mirat kjellore;në vend të të përkohëshëmëvet të pasosmet,në vend të të prishëmëvet,të paprishëmet.

Kujtou , o i Madh'in'Zot,për ata çë rrojën ndë shkretirat,te malet,te shpellat,te vërat e dheut. Kujtou për ata çë rrojën në virgjëri,në lutësi, në përkorie ,në gjellë të pastrë.

Kujtou për kjivertarët t'anë kuj i dhe të kjivarrisiën punat e dheut; kurorëzoi me të vërtetën e me dasha-mirësi;pështroi kriet e 'tire në ditë luftie,mfortsoi krahun,ngrei të dërëjtën,jipi pushtét kjivarris s'tire;vëri përposh 'tire,gjindet varvarë çë duan luftë;falii atireve një pakjie e kthelle dhe e paprerë;foli të mira te zëmbrat e 'tire pér Klischën t'ënde e gjithë popullin t'ënt,sa edhé na ndë të pakjet e 'tire të shkojën gjellën të kjetëme e të prérët ndë lutësi e me nder. Kujtou pér gjithë krerat e udhëhékjësitë e pér vëllézërit t'anë çë rrojën te shpit e 'tire e pér ush- 202.

ESPERINOI E MESHA E T'INTIES s'MADHE

trin. Të mirët ruaji te mirësia jote; të likjtë bëji të mirë me lipisin t'ënde. Kujtou,o i Madh'in'Zot,për populin çë ke këtu përpëra e pér ata çë lipsen pér shkake të arsyeshmë e kij lipisi pér këta e pér atapér sa e mëdhe isht lipisia jote;arkat e 'tire mbëloj me gjithë të mirat;ruaji martesat e 'tire në pakjie e njëmendie;rrit fëmijën;nësò të rit,jip fukji plekjëvet;jip zëmërë trëmbësarëvet;mbëjith të shprishurit;prir të larguarit e bashkoi te Klisha shejte katholike apostolike. Lirò ata çë janë ngarë nga shpirtra të fëllikjurë;lundrò bashkë me udhëtarët;kujdesou pér të vejat;mbrò të varfëritë;lirò të burgosuritë; bëj mirë të sëmuritë. Kujtou pér gjithë ata çë ndodhen nën gjikim,çë shërbëjën te minët,në mergim,te shërbëtirë

ESPERINOI E MESHA E TË INTIES

të rënda, çë ndodhen në helm e në mbëhi. Kujtou, o i Madh'in'Zot, përgjithë ata çë lipiën lipisìn t'ënde të madhe. Kujtou për ata çë na duan mirë e për ata çë na mbajën mbëri, për ata çë na truhen te parkalesia, nёve të pavojfshmё sa të lutemi për ata.

Përgjithë popullin t'ënt kujtou, o i Madh'in'Zot Perëndia jinë, e mbi gjithë derth lipisit t'ote të shuma tue falur gjithëve atë çë të lipiën sa të shpëtonen. Kujtou edhé për ata çë ngë kujtuam na a përqë ngë i njohiën a i harruam a përqë émbret janë të shumë. Kujtoi Ti, o i Madh'in'Zot, se Ti të çenjérit i njeh vietçët e émbrin, Ti çë na njeh të gjithë çë nga gjiri i mëmës. Se Ti, o i Madh'in'Zotje ndihma e atireve çë ngë e kanë, shpresa e të dëshpëruamëvet, shpëtimi i atireve çë janë trazuarë nga furturët e dimërit, limani i lundronjësëvet,

ESPERINOI E MESHA E T'INTIES

miekü i të sëmurëvet. Klofshe Ti gjithkjish për gjithë njeri, Ti çë na njeh një për një e mbëhit e të lipurat t'ona. Shpëtò, o i Madh'inë Zot, këtë kjitet e nga kjitet dhe horë nga murtaja, nga uria, nga të tundurit e dheut, nga përbritie, ziarre, lufta, sulme të huaj e lufta ndër nesh. Kujtou, o i Madh'in'Zot, përgjithë ipeshkëpët e orthodhoksëvet çë shpalliën drekjë fiälën e vërtetëties s'ate. Kujtou edhé, për sa të mëdha janë përdëjesat t'ote, për pavlerësin t'ine.

Ndëjémë çëdo faj të bër tue dashur e pa dashur e nos mbaj dhuratën e Shpirtit Shejt nga këto dhureti të paravume për mëkatët t'ime. Kujtou për priftërin, për diakérin te Krishti e për gjithë urdhurin priftërisht e mosnjérin turpërò ngak na çë rrëthojëm Theranë t'ënde të she-

jte. Shtie një si mbi ne te mirësia jo-te. Dëftou me të kjosmet përdëjesa t'ote, o i Madh'in'Zot.

Falna erë të buta e të dobishme; dhurò shira të pakjëmë sa t'binjë shumë pemë; bekò kurorën e vitit me të mirat t'ote. Pushò ndamiet e Klishëvet, shuaj tèrbimet e kombëvet, shpejt shtip me fukjìn e Shpirtit Shejt kriengrititet e eresivet. Gjithë ne pritna mirë te rregjëria jote tue na bër neve bij të dritës, bij të ditës. Falna pakjien e dashurin t'ënde, o Zoti Perëndia jinë, se gjithkjish Ti na ke dhënë.

'O Θεὸς ἡμῶν, ὁ Θεὸς τοῦ σώζειν...

Perëndia jinë, Perëndi të shpëtuari, Ti na mësò neve si të vëjéfshmë të T'faliëm nderies s'ate pér të mirat çë na ke bër e çë po na bën.

Ti, Perëndia jinë, çë prite mirë këto dhureti, pastrona nga çëdò ngjolle mi-shi e shpirti; mësona të nbarojëm të shejtëruanit t'anë te trëmbësira jote, sa nö deshmi të dëlirë të vetëdijës s'anë të marriëm piesë te shejtërimet t'atë e të bashkonemi shejtit Kurm e Gjak të Krishtit t'ënt e, tue i marrë të vëjéfshmë, të kemi Krishtin çë jet te zëmbrat t'ona e të bënemi na faltore të Shpirtit Shejt.

Ëj, Perëndia jinë, e mosnjérin ngak na çë u kungua me Misteret kjielli i, sëmur në kurm e nö shpirt të dëngosh se u kundua i pavëjéfshëm. Po ëna neve njera tek e sprasmia frimë të marriëm piesë te shejtërimet t'atë si udhöhékjësë te jetës të pasosme, si mbronjësë të mirëpriturë nga gjikatorëja e dreruame të Krishtit t'ënt, sa edhé me gjithë

ESPERINOI E MESHA E T'INTIES

Shejtrat t'atë, çë moti Tij pëlkjieshmë, të bënemi piestarë të të miravet t'ote të pasosme çë Ti përgatite atireve çë të duan mirë, o i Madh'in'Zot.

falnderimi pas Kungimit

Të falemi nderies s'ate, o Krisht Perëndia jinë, se na vure në piesë të të shejtëvet, të dëlirëvet, të pavdekshmëvet; n së kjielli Misterë t'atë çë na dhe neve për të mirën, për shejtërimin, për shëndetën e shpirtravet e kurmövet. t'anë. Ti, o i Zoti i gjithësis, bëj se kë kungim i shejtit Kurm e Gjak të Krishtit t'ënt. të jet për besë pa turp, për dashurë pa pështrim, për të mbushur diturie, për shëndetë të shpirtit e të kurmit, për të larguarit e çëdë armiku, për të ruajtur urdhurimet t'atë, për mbrojtje e mirpriturë tek e dreruashmia Gjikatore të Krishtit t'ënt.

ESPERINOI E MESHA E T'INTIES S'MADHE

Parkalesi rëzraza Vimës "opisthomachia" to Meshët e shën Vasilij t'mond' t'tuhet këjë: 'Θυσίαν αἰνέσσεως καὶ λατρείαν

O Krisht Perëndia jinë, Ti çë pret mirë këtë flijim të papërgjakshëm e të mendgëm si flijim lëvdimi e latrë të këndëshme nga ata çë të thërresiën me gjithë zëmërë, Ti je kjenkji e i Biri i Perëndis çë ndsier mëkatën e jetës, viçi i pafajshëm çë ngë do dsigoin e mëkatës e për ne e nglakon me-hir; çë bënët piesë piesë e ngë ndahet; çë hahet e kurr soset e shejtëron kë i nerr piesë. Ti për kujtim të pesinevet t'atë çë deshe të duroje e të të ngjallurit të triditëshën gjallsor t'ënt na böre të mirriën piesë te misteret t'atë të pathënëshnë, 'n së kjielli e të dreruashmö të shejtit kurm t'ënt e të qumavit gjak.

Ruaj te të shejtëruarit t'at neve shërbëtorë t'atë, diakërit e të besmit kqivertarë t'anë e ushtrin të krështere e popullin të këtushën.

ESPERINOI E MESHA E T'INTIES

E ëna neve në çëdò kohë e kjérò të mejtojëm dërejtërin t'ënde sa , të udhëhékjurë ndaj vullimit t'ënt e tue bër atë që Tij të pëlkjén, të bënemi të mirë të rrin tek e dërejta jote kur të vishë të gjikoshë të gjallitë e të vdekuritë. Lirò vëllézërítë t'anë çë janë robë; prir siun t'ënt mbi ata çë janë të sëmurë; kjëvarris ata çë ndodhen në rrëzikje; shpirrat e të ndëjémëvet çë vdikjén me shpresën e gjellës s'pasosme préj atié teku shkëlkjén drita e fakjies s'ate e gjekjë gjithë ata çë të lipiën ndihmë. Pse Ti je dhënësi i të miravet e Tij të japiëm lëvdì bashkë në të pazënин At t'ënt e gjithëshejtin e i mirë Shpirt t'ënt, nani e pérherë e pér jetë të jetëvet, amìn.

e prierrë nga Protesi thot:

"Hvitorai nai tetëlëstorai.....

Sosi e u mbarua, pér sa mëndë na , misteri i ikonomis s'ate, o Krisht Perëndia jinë, Kujtuam Vdekjen t'ënde; pam fitirën e Ngjallies t'ënde; u

ESPERINOI E MESHA E T'INTIES S'MADHE

mbushëm me gjellën t'ënde e patësosurë; gëzuam lumërin të pashuashme t'ënde të t'çilës bënna të mirë, neve të gjithë, tejeta e ardhshme paj të Dhurastës e të pazënitet At e të t'Shejtët e të mirë e gjellëdhënës Shpirt t'ënt, nani e gjithëmonë

MEGALINARI I SH.VASIJIT

Kjiell-folësin e Krishtit, dsënësin e Zotit, illin të ndritshëm, nga Kjesaria e Kapadhokjëvet Horë, VASIJIN i MATH të gjithë nderojëm na.

në vend të Hjeruvikoit e Kjinonikoit këndonet: To ū Δείπνου σου το ū...

Te darka jote mistike, o i Biri i Perëndis, bën më sot të marr piesë edhë u:pse u misterin t'ënt s'ja thom armikjëvet, as të jap të puthur si beri Judha, po si kusari u Tij të thom: kujtou pér mua, o Zot; kujtou pér mua o i Zot; kujtou pér mua o i Shejt, si të vi shë te rregjëria jote.

O R T H R O S i t  PR MPTIES s'MADHE

Nd rsa sg idhen "6 msalmet" (v. f. 5)
Prifti sg eth lutie mistikjishu:
(f. 61).
Pas "alilujarit" k ndonet :

Ote i endhoksi Mathit  (f. 127)

Kur Apostojit  ...

si sos ki k ndim sg idhet i pari Vangjej.

Prifti : E sa t'jemi b r t  mir  t 
gjegjemi Vangjejin Shejt i lutemi
t'in'Zoti.

Lipisi, lipisi ...

I Jani 13, 31 - 18, 1.

In'Zot i tha ds n s vet e'Tij: Nani
e pati l vd n i Biri i njeriut e Pe-
r ndia tek A  u nderua. N  Per ndia
tek A  pati nderin, edh  Per ndia ka
l vdonj  At  n  vet h  e shpejt do t 
e l vdonj . Bijzit e mi, edh  pak U

ORTHROS I TË PRËMPTIES S'MADHE

jam me ju:kini të më kërkoni,e ashtu si i thash Judhenjëvet:se atié ku U vete,ju ngë mëndë të vini;e nani ju e thom juve. U ju jap një urdhuril të ri,të duhij mirë njeri t'jetérin: ashtu si U ju desha mirë juve,edhé të duhij mirë njeri t'jetérin. Kështu! ka t'ju njohiën gjithë,se jini dsënësit e mi: paçit të dashur njeri me t'jetérin. I thot Atij Simon Pietri:Zot,ku vete Ti? Iisui ju përgjekj:Atié ku U vete,ti nani ngë mëndë të më vish prapa,por ke pran të më vish prapa. I thot Pietri:përçë ngë mëndë u nani të vinj prapa Tij ?

Iisui ju përgjekj. Ti do t'vesh gjellën t'ënde për Mua ? Me të vërtetë, me të vërtetë U të thom: Ngë ka t'këndonjë gjeli,njera çë ti tri herë ke të më mohosh.

Le t'mos tërbonet zëmbra e juaj:kini besën te Perëndia e t'e kini besën e-

214.

ORTHROS I TË PRËMPTIES S'MADHE

dhé tek U. Te shpia e Tatës t'im janë shumë vendë:e në mos ishë kështu',ju e kisha thënë;U vete t'ju dërtonjë vendin për ju. E si të vete e të ju këm dërtuar vendin, pran U dua vinj pameta e ka t'ju marr juve me Mua,sa ku t'jem U,të jini edhé ju; e te ku vete U ju e dini,edhé dini dhromin.

E Tomasi i thot:Zot,na ngë e dim ku vete Ti,e si mëndë të dim udhën ?

Iisui i thot atij:U jam Udha,edhé e Vërteta,edhé gjella;mosnjeri vien te Tata veç se me Mua. Në kishët njohur Mua,kishët njohur rdhé Tatën t'im: e çë nani ka t'e njihëni,por edhé e kini par. I thot Filipi: Zot,dëftona Tatën , e neve na arrën. Iisui i thot atij: Sa mot ka çë jam me ju,e ti,Philip,ngë më ke njohur? Aì çë ka par Mua,ka par edhé Tatën,e si thua Ti: dëftona Tatën? Ngë ke besë se U jam te Tata e se Tata isht tek U ? Fialët çë U ju thom,ngë i flas nga vetëheja jime:e Tata çë mbet tek U,isht Aì çë bën veprat.

215.

ORTHROS I TË PRËMPTIES S'MADHE

Kimëni besë, (kur ju thom) se U jam te Tata, e se Tata isht tek U:ndomës, më kini besë pér këto vepra. Me të vërtetë, me të vërtetë ju e thom, se Kush ka besë tek U, veprat çë U bënja, ka t'i bënja edhé aì:po edhé më të mëdhà se këtò aì ka t'i bënja:pse U jam e vete te Tata jim. E çëdò të lipëni mbi émbrin t'im, u kam t'e bënja, sa të jét ndertur i Jati tek i Biri. Në do lipëni gjagjë gjagjë mbi émbrin t'im, U ka t'e bënja.

Në më doni mirë, ju po ruani urdhurimet t'imë. E U dua t'i lutem Tatës, e Aì ka t'ju japënja nj'atér Përgëzuar, sa të rrié bashkë me ju gjithëmonë, Shpirtin i së vërtetës, të qilin jeta ngë mënd' t'zënja, se ngë e sheh e ngë e njeh: por ju e njihëni, se po mbet me ju e ka t'jet tek ju. U ngë ëua t'ju lë të varfrë: po dua t'vinj prap tek ju. Edhé pakë e jeta ngë më sheh më. Por ju më shihëni, se u rronj e ju ka t'rroni. Tek ajo ditë ju ka t'njihëni,

ORTHROS I TË PRËMPRIES S'MADHE

se U jam te Tata jim e se ju tek U, edhé U tek ju. Aì çë mban urdhurimet t'imë edhé i ruan ki isht aì çë Mua më do mirë: e aì çë mua do mirë, ka të jet dashur mirë ka Tata jim e U ka t'e dua mirë e ka t'i sblonem atij vetëhén.

I thot Iisuit Judha-jo Iskarioti:- çë kle, se neve ke të dëftonesh, e jetës jo? Iisui ju përgjekj e i tha atij: në një më do mirë, fialën t'ime ka t'e ruanjë: e Tata jim ka t'e det mirë, e duam të vijëm tek aì e ka t'jésiën tek aì. Aì çë ngë do mirë mua, aì ngë ruan fialët t'ime: e fiala çë ju gjegjë, ngë isht Jimia, por isht e Tatës t'im çë më Përgoi. Këto të fola U juve kam bër psa gjëndem me ju. Përgëzori pra, Shpirti Shejt, çë Tata ka t'dërgonjë nbi émbrin t'im, Aì ka t'ju mësonjë gjithkjish, e ka t'ju kujtonjë juve gjithë atë çë U ju kan thënë.

Pakjie U ju lë, ju jap juve pakjien t'ime: U ngë ju e jap ashtu si e jep jeta. Mos të trazonet zëmbra juaj, as të trëmbet. Ju e gjegjët se U ju thash: Jam e vete e pra vinj tek ju.

ORTHROS I TË PRËMPTIES S'MADHE

Në më dejët mirë , ki't'gëzonij se U thash:vete te Tata;se Tata jim isht më i math se U. E nanì ju e kam thënë më para se të strekset,sa,kur të streksënje,t'e kini besë. U ngë dua flas më shumë me ju,se isht e vien i Pari i kësaj jetie, e ki piesë me Mua s'ka gjë fare. Por sa t'njohënje jeta,se U dua mirë Tatën e ashtu,si më urdhuroi Tata,U bënj. Ngrëhij,vemi këndisha. U jam dhria e vërtetë e Tata isht bulku. Nganjë vllastar çë tek U ngë pie pemë,Aì e köpun;e nganjë vllastar çë bie pemë,Aì e kjéròn,sa të bienjë pemë më shumë. Ju nanì jini kjëruam me atë fialë·çë kam folë juve. Ju mbétëni tek U,edhé U tek ju. Ashtu si vllastari ngë mëndë të bienjë pemë,në ngë mbetet ngjitur te dhria,ashtu edhé ju ngë mëndë,në mos mbetij tek ës. U jam dhria,ju jini vllastarët;ai çë kjëndron tek U , e U tek aì,ki bie shumë pemë:se pa klënë U,ju ngë mëndë të bëni mosgjë.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Në një ngë mbahet me Mua,ka t'jet shtur jashta si vllastari,e ka të thahet: e i mbøjedhiën ata e i shtier te zjarri e ata digjen. Në kjëndroni me mua,e fialët t'ime kjëndrojën tek ju,lipëni atë çë doni e ka t'jet bër juve. Mbë këtë isht lëvduar Tata jini se të bini shumë pemë,e kështu do të jini dsönësit t'imë. Ashtu si Tata Mua më deshi mirë,edhé U ju desha mirë:kjëndroni te të dashurit t:im. Në më ruashit ju urdhurimet t'imë,kini të kjëndroni te dashuria jime,ashtu si U kam ruajtur urdhurimet e Tatës t'im e mbetem te dashuria e 'Tij.

Mbi këto shërbise U kam folë me ju,sa gëzimi i jim të mbetet tek ju,e gëzimi i jij të jet i plot.

Ki isht urdhurimi jimi jim: sa të duhij mirë njeri me t'jatrin,ashtu si U ju desha mirë. Më të mathë të

ORTHROS I TË PRËMPTIES

dashur ngë ka njeri mö se köta të
 dashur çë ka ai çë jep gjellën pér
 mikjët e 'tij: e ju jini mikjët e mi,
 në ju bëfshit gjithë atë çë U ju ur-
 dhuronj. U ngë ju thom më juve shër-
 bëtorë, se shërbëtori ngë di atë çë
 bën i zoti; por U ju thash juve mikjë,
 pse gjithë atë çë U gjegja nga Tata
 jim, U juve e bëra sa t'e dsëjët.

Ngë jini ju çë kini sgledhur Mua, por
 U ju kam sgledhur juve, e ju vura sa të
 veni e të bini pemë e pema juaj të
 kjëndronjë:sa andai çëdë t'i lipëni
 Tatës t'im mbi embrin t'im, Aì t'ju e
 japënje. Këtë U ju urdhëronj:sa të du-
 hij mirë njeri me t'jatrin. Në jeta
 ju do kekjë, t'e dini, se më para se ju-
 ve, ajo Mua më ka dashur kekjë. Në ju
 ishët nga jeta, jeta kish t'dej mirë
 të sajt. E pse ju ngë jini nga jeta,
 prandai jeta ju do kekjë. Mbani në
 mendë fialën çë U ju thash: ngë ndo-

ORTHROS I TË PRËMPTIES

dhet shërbëtar më i mathë se i zoti.
 Në kanë ndjekur Mua, edhé juve kanë
 të ju ndjekiën. Në kanë ruajtur fialën
 t'ime, edhé t'ëjën kanë të ruajën.

Por këto të gjitha ata ka t'i bëjën
 juve paj t'embrit t'im, pse ngë njohi-
 ën ata Kush më dërgoi. Në ngë kisha
 jardhur e në ngë kisha folë atireve,
 mëkatë ata ngë kishën e nani ngë kanë
 si të pështrojën mëkatën e 'tire.

Kush mban mbëri mua, i mban mbëri edhé
 Tatës t'in. Në ngë kisha bër ndër 'ta
 veprat çë mosnjeri kurr nj'atër ka
 bër, ata mëkatë ngë kishën; nani ata i
 kanë par, e kanë dashur kekjë Mua e
 Tatën t'im. Por (këtë kle)sa të mbaro-
 net fiala e shkruame te ligja e'tire:
 se më deshën kekjë dhurat (pa pasur
 ligjë). Kur pran të vinjë Përgëzori,
 çë U kam t'ju dërgonjë nga Tata (Sh-
 pirti i së vërtetës çë vien nga Tata)
 Aì ka t'bënje martirë pür mua. E ju
 edhé ka t'bëni martirë, pse çë më para

ju jini me Mua. Këtë U ju e kam thënë, sa mos t'kini skëndal. Ka t'ju përzën nga sinagogët; e ka t'vinjë hera çë kush ju vret juve, do t'ket besë se i jep·nder Perëndis. E këto shërbise kan't'i ju bëjën juve, se ngë njohën Tatën, as njohën Mua. Por mbi këto U ju kam folë sa, kur të vinjë hera, të i kujtoni, se U ju i kam thënë:këto çë përpara U ngë ju i thash, se isha me ju. Nanì U vete tek Aì çë më dërgoi e mosnjeri tek ju më pien:ku vete?

Por, se U ju kam folë kështu, helmi ju mbëloj zënbrën t'ëj. Po U ju thon të vërtetën: se isht mirë pér ju, se U të vete; pse në ngë vete U, Përgëzoni (Shpirti Shejt) ngë do t'vinjë tek ju, por si të vete U, ka t'ju e dërgonj juve. Edhé Aì kur të vinjë, ka t'kjertonjë jetën pér mëkatën, pér drejtërin, e pér gjikimin.

Mbi mëkatën, pse ata ngë patën besë tek U; mbi drejtërin, pse U jam e vete te Tata jim, e ju ngë në shihëni më; mbi gjikimin pra, pse i Pari i kësaj jetie kle gjikuar. Edhé shumë shërbise kam t'ju thon juve, por nanì ngë mënd't'i kjellëni. Kur pran të vinjë Aì, Shpirti i së vërtetës ka t'ju udhöhékjnëngë mbë gjithë të vërtetën, përcë Aì ka të flasënëngë nga vetëhëja e 'tij, por gjithë atë çë ka gjës gjur, ka t'flasënëngë e ka t'ju thet më para atë çë ka të strekset.

Aì ka të nderënëngë Mua, pse Aì ka të marrënëngë nga t'imët e ka t'ju e dëftënëngë juve. Gjithë atë çë ka Tata i isht t'imët; andai thash, se Aì ka të marrënëngë nga t'imët e ka t'ju e dëftënëngë juve. Edhé pak, e ngë më shihëni: e paneta pak, e kini të më shihëni, se u vete te Tata. Atë herë tsa vetë nga dsënësit e 'tij thanë ndër 'ta njeri t'jatrit: çë vien më rar këtë çë neve Aì na thot: "Edhé pak

ORTHROS I TË PRËMPTIES

e ngë më shihëni; e pameta pak, e kini të më shihëni se U vete te Tata?"

Thoshiën andai ata: Çë isht këta:"edhé pak"? na ngë dim pér çë flet.

Ndëlgoi Iisui se dejën t'i piejën e i tha atireve: Mbi këtë shërbes ju ndër ju kërkoni të dini njeri me të jatrin, se ju thash: EDHE PAK, E NGË MË SHIHËNI; E PAMETA PAK, E KINI TË MË SHIHËNI? Me të vërtetë, me të vërtetë, U ju thom, se ju kini të klani edhé të vajtoni, e jeta ka t'gëzonet; ju kini të helmonij, por helmi i jij ka t'pri-ret në gëzim. Gruaja, kur t'i lehet, ka helm, se i jerdhi hera e 'saj; kur pra i ka ler diali, ngë kujtonet më ka helmi pér gëzimin, se u le një njeri te jeta. Andai edhé ju nanì kini helm: pra kam t'ju shoh pameta e ka të gëzonet zëmbra e juaj, e gëzimin t'ëj mos-njeri mëndë të ju e ndsierënje. E tek ajo ditë mosgjë që t'më pieni. Me të vërtetë, me të vërtetë ju e thom, se çëdo të lipëni Tatës t'im mbi embrin t'im, Aì ka t'ju e japënje.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Njer më nanì ngë kini lipur gjë mbi émbrin t'im: lipëni e ka t'kini, sa gëzini i jij të jet i plot. Këto shërbise ju i kam thënë tue folë me parabulla: por vien hera kur ngë ka t'ju flas më me parabulla, po sbëluarith kam të ju rrëfienj mbi Tatën t'im. Tek ajo ditë mbi émbrin t'ini kini të lipëni: e ngë ju thom se ka t'i lutem Tatës pér ju përsé Aì ju do mirë Tata-vet, pse ju më kini dashur mirë Mua, e kini pasur besë, se U dolla nga Perëndia. U dolla nga Tata e jerdha te jeta: përsëri lë jetën e vete te Tata. I thonë dsënësit e 'Tij:shesh, nanì Ti flet sbëluarith e ngë thua parabulla. Nanì dim se Ti di gjithkjish, e pér Tij ngë i duhet se të të pienjë ndonjeri: prandai na kemi besë se Ti dolle nga Perëndia. Ju përgjekj atire Iisui: Nanì ju kini besë: Shi' se isht e vien hera, po edhé jerdhi nanì sa ju të jini shprishurë nga një pér 'të, e më lëni të vetëm, po s'j s'jam i vetëm U, se me Mua isht Tata.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Kështu U ju kam folë, sa t'kini pakje tek U. Te jeta ka t'kini helm, po bëni zëmërë: U e munda jetën. Iisui foli kështu e pra ngrëjti sit te kjiellia e tha: Tate, isht arrënë hera: Ti lëvdò t'ët Bir, sa edhé jit Bir të lëvdonjë Tij; ashtu si Ti i dhe zotëri mbi gjithë njeri, sa nga-një çë Ti i dhe, Aì t'i japënë atireve gjellë të pasosme. Këjò isht gjella e pasosme, sa t'njohiën Tij, t'vetmin Perëndi të vërtét edhé Iisu Krishtin çë Ti dërgove. U Tij të lëvdova mbë dhet: veprën çë Ti më ke dhënë të bëja, U e sosa: e nanì Ti lëvdò Mua, Tate, me vetëhén t'ënde ndë lëvdì çë U kisha me Tij më para se t'ishë jeta. U dëftova émbrin t'ënt njerzëvet çë Ti më ke dhënë nga këjo jetë. Ishën t'atët e m'i ke dhënë Mua, e ata kanë ruajtur fialën t'ënde. Nanì kanë njohur se gjith'atë çë ti më ke dhënë, vien ngak Ti. Pse të folët çë Ti më ke dhënë, U ja kam dhënë atireve e ata e muartin e njohën me të vërtetë, se'n Teje U

ORTHROS I TË PRËMPTIES

dolla edhé patën besë se Ti më dërgove. U pér ata lutem, ngë lutem pér jetën; po pér ata çë Ti më ke dhënë, se janë t'atët. E gjithë t'imet janë t'otet, e t'otet janë t'imet e u kam klënë lëvduar tek ato. E U ngë jam edhé më në këtë jetë, e këta janë në këtë jetë e U jam e vinj tek Ti. Ati i shjet, mbë émbrin t'ënt ruaji Ti ata çë më ke dhënë, sa t'jen'njëzë si jemi Na. Kur isha me ata te jeta, U i ruaja mbë émbrin t'ënt. Ata çë më ke dhënë U i ruajta e mosnjeri nga ata u sbuar po vetëm i biri i sberries, sa të mbaronet e Shkruamëja. E nani jam e vinj tek Ti, e këto u i thom, si ndodhem në jetë edhé, sa ata të ken të plot gëzimin t'im ndë vetëhë të 'tire. U ja kam dhënë atireve fialën t'ënde; e jeta i deshi kekjë, se ata ngë janë të jetës, ashtu si U ngë jam të jetës.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

U ngë lip t'i ndsiersh nga jeta, po lip sa t'i ruash nga i ligu. Ata ngë janë të jetës, si edhé U ngë jam i jetës. Shejtëroi Ti tek e vërteta e jo-te: Fiala jote isht e vërteta. Ashtu si Mua Ti më dërgove te jeta, edhé U i kam ata dërguar te jeta. E paj t'a-tire U shejtëronj vetëhén t'ime, sa edhé ata të jenë shejtëruarë mbë vërtëtë. Por ngë lutem vetëm pér këta, se edhé lutem pér ata çë do t'ken besë tek U me fialën e 'tire, sa të gjithë të jenë njëzë, ashtu si Ti, Tata, je tek U e U tek Ti, të jenë njëzë ata tek Na: sa jeta të ket besë se Ti më dërgove. Edhé nderin çë Ti më ke dhënë U atireve ja kam dhënë sa t'jenë njëzë ashtu si Na jemi po një. U tek ata e Ti tek U sa të jenë të sosurë mbë një e sa jeta të njohënë se Ti më dërgove e se i ke dashur mirë ata ashtu si Mua më ke dashur mirë.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Tate, U dua se ku jam U të jenë bashkë me Mua edhé ata çë më ke dhënë, sa të shohiën lëvdin t'ime çë më ke dhënë: pse Ti më deshe mirë çë më para se të stisurit e jetës. At i dërëjt, jeta ngë të njobu, por U të njoba e këta më njohën, se Ti më dërgove.

E atireve bëra të njihiën émbrin t'ënt e ka t'bënë t'e njihiën edhé, sa tek ata të jet ajo dashuri me të cilën Ti më deshe mirë: edhé U të jem tek ata.

Të thënit kështu duall Iisui bashkë me dsënësit e 'tij e vate mb'at'anë përroit e kjedhronit teku ishë një kopësht te cili hiri Aì edhé dsënësit e 'Tij.

*nga herë, si sos Vangjeji,
thomi:*

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Lëvdì të njomës Zémërës s'ate

Lëvdì dashamirësis s'ate

Lëvdì të pérunjurit t'at

Se me-hir deshe të jipeshe vde-
kjies pér ne !

Δοξε τῇ μακροθυμίᾳ σου, κύριε δόξα σο
ψιλαν δρόσιται σου Δεσπότα. Δοξε τῇ
Αντιφόνα ε 1 ουνκαταβάθει
"Αρχοντες λαῶν ...
οτι Εχάγμων
παρεδόμενοις
τον

Të Parët e popujvet u mbëjodhën ~~sun-~~ ^{Els}
dra t'in'Zoti e kundra Krishtit t'Tij ~~oux~~ ^{τον}
Λόγον παράνομον ...

Një të ngalesur të pa-ligjëparakjitën
kundra Meje. O Zot, o Zot, mos më le.

Tàç aitoshës...
Njenjat t'ona të pastra faliëm Kri-

shtit e si mikjë të 'tij bëjëm fli-
jë shpirtrat t'anë pér Atë e mos mbi-
230;

ORTHROS I TË PRËMPTIES

temi si Judha te pérkujdeset e gjellës;
po te të brëndëshmit e zëmbravet t'ona
le të thérresiëm:Ati jinë çë je në kji-
ell, lirona nga i ligu.

dhoksa ...kje nin...Παρθένος ἔτεινες;; .
~~η~~

Virgjérë linde, Virgjérë kjëndrove, Më-
më e panusérte, Mëri, Mëma e t'in'Zoti.

Lutu Krishtit Perëndia jinë të na sh-
pëtonjë.

Antifóna e 2

"Εδραμε λέγων ...

Rrođhi Judha t'i thëshëj shkruesëvet
të paligjë:çë doni t'më jipëni e u ju
e jap te duart? E Ti pa klënë par ndo-
dheshe në mes t'atireve çë flisiën mbi
Tij. O zémërënlohës, shpëtò shpirtrat
t'anë.

'Ev èlës...
Me dashuri shërbëjëm t'en'Zonë si bë-
ri Marieja te darka e mos lëhemë të
jemi marrë nga lakmia e 'rrëgjëndit sa
t'jemi gjithëmonë me Krishtin Perëndi.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

dhoksa ... kje nin ... " Ov ūteneç.

Mos le të parkalésesh kurdoherë Atë
çë Ti linde, o Virgjérë, me viershë të
pandëlguashëm, Mikun e njeriut, sa të
ruanjë nga rrëzikjet ata çë rrriedhiën
tek Ti.

A n t i f o n a e 3.

Διὰ Λαζάρου τὴν ἔγερσιν... *ηχος β'*

Për të ngjallurit e Lazarit, o Zot,
fëmija e Ebrenjëvet ulurijën Tij O-
SANNA o Njeridashës; po i paligji Ju-
dhë ngë deshi të ndëlgoj .

'Ev τῷ δεῖπνῳ σου ...

Që më para te darka, o Krisht Perëndi,
thëshie dsënësëvet t'atë:një ngak ju
ka të më trathëtonjë; po i paligji Ju-
dhë ngë deshi të ndëlgoj.

'Iwávvı̄ ...

Janit që të piej, o Zot, çili ishë për-
dhënësi, Ti ja ftove me anën e bukës,
po i paligji Judhë ngë deshi të ndëlgoj.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Elç trilamontë ërgjyrija...

Me tridhietë dënarë e një të puthie
dinake körkojën Judhenjtë të të vri-
siën; po i paligji Judhë ngë deshi të
ndëlgoj.

'Ev τῷ νιπτῆρί σου...

Pas çë i lajte, o Krisht Perëndi, i li-
pie dsënësëvet t'atë:bëni kështu ju si
patët bër; po i paligji Judhë ngë deshi
të ndëlgoj.

Γρηγορεῖτε καὶ προσεύχεσθε...

Rrini sgjuarë e parkalesni, mos të bini
në ngarie, Ti o Perëndia jinë thëshie
dsënësëvet t'atë; po i paligji Judhë
ngë deshi të ndëlgoj.

dhoksa; ..kje nin ... Διάσωσον ...

Lirona Ti nga çëdë rrëzikje, Ti Zonj'e
Mëm'e t'Lartit, se të gjithë pas Perën-
dis tek Ti na po rrriedhiëm, si në mur
pa të çar edhé te mbrojtësia.

ORTHROS I TÈ PRÈMPTIES

„Ετι και Ετι...“

"Οτι εύλογηται και δεδόξασται τὸ πάντιμον, και μεγαλοπρεπὲς ὄνομα σου τοῦ Πατρὸς..."

Kάθισμα: Εν τῷ δείπνῳ... *Hxos fupos*
Te darka, si ushkjeje dsënësit t'atë,
e njihie mendimin e trathëtis e kjërt-
tovë Judhën për 'të mbigjithë se dije
se aì ishë i pandrekjshëm, po sa gjithë
të dijën se jipeshe me-hir te du-
art e 'tire sa t'rrëmbeje jetën nga
armiku. O zëmëgjerë, paçe lëvdì!

I DIJTI VANGJEJ
(Jani XVIII, 1-28)

Tek ai kjérò duall Iisui ·bashkë me
dsënësit e 'Tij e vate mb'at'an'pér-
roit e kjedhronit, te ku ishë një kó-
pësht, te çili hiri Ai edhé dsënësit
e 'Tij. Atë vend njihëj edhé Jëudha
çë ish'e jipëj në duar Iisuin:pse
disa herë mbëjidhej atié Iisui bashkë
me dsënësit e 'Tij. Andai Jëudha mori

ORTHROS I TÈ PRÉMPTIES

lusm n ushtar sh e sh rb tor t  e i
dhan  t  Par t e priftravet e Farise-
njt  e vate ati  me h rnare e vrava-
shke e me arm . Iisui , se e dij gji-
th  at   e ish'  i vij mbi 't , i dol-
li p rpara e i tha atireve: K  k rk -
ni? Ju p rgjegj n Atij:Iisu' Nazare-
nin. I thot Iisui atireve: Jam U.

Judha, çë ish'e ja jipëj në duar,
ishë edhé ai bashkë me ata. Ashtu'
si Iisui i tha atireve: Jam U; ata u
shtun prapa e ran te dheu. Pra pame-
ta Iisui i piejti: Kë kërkoni ?

E ata thanë:Iisu Nazarenin . U përgjekj Iisui: ju e thash se jam U: në pra kërkonî Mua, lenii köta të venë; e kötë sa t'mbaronet fiala çë Ai kishë thënë: se "U ngë kam sbierrë mosnjérin tek ata çë Ti më ke dhënë".

Atë herë Simon Pietri, se kishë shpat-tën, e holkji e i ra shërbëtorit e Kriepriftit e i preu veshin e drejt:

ORTHROS I TË PRËMPTIES

kötij i thoshiën Malku. Por Iisui i tha Pietrit : vur shpatén t'ënde te milli ;kjelkjin çë Tata Mua më ka dhënë,ngë ka t'e pi U ? Ushtarët pra e kaptenja e shërbëtorët e Judhenjëvet e zun Iisuin e e lidhën e e kjellën më para te Anna,se ishë ki i vienhërrri i Kajafës,i çili ishë krieprifti i atij viti. Kajafa ishë ai çë kishë dhënë këshill Judhenjvet se isht mirë sa të vdesënë një njeri vetëm pér popullin . E Iisuit i vej prapa Simon Pietri e jatëri dsënës: e ki dsënës ishë i njohur ka Krieprifti e hiri bashkë me Iisuin te trémeja e Kriepriftit;por Pietri u mba jashta kaldera. Pra jatri dsënës çë ishë njohur nga Krieprifti dolli e ,posa foli me gruan te dera,bë të hij Pietri.

E shërbëtoria e derës i thot Pietrit: mos edhé ti je nga dsënësit e këtij njeriu? Ai thot: Ngë jam; E shërbëto-

ORTHROS I TË PRËMPTIES

rët e punëtorët rrrijën të ngroheshin atié shtuara te ziarri çë kishën bër se bëj tëtim:e Pietri ishë me ata shtuara e ngrohej. Krieprifti pra i piejti Iisuit mbi dsënësit e 'Tij e mbi të mësuarit e 'Tij. Ju përgjekjë Iisui: U kam folë jetës sbëluarith:U U gjithë herët kam mësuar te singoga e te Faltoreja,teku mbëjidhen Judhenjtë nga gjithë anët e ngë kam folë mosgjë fshehur:përcë më pien Mua? Pieji atireve çë më kanë gjegjur mbi atë çë atire kam folë:shi' se ata e din mirë atë çë U kam thënë. Si Iisui tha kështu,një nga shërbëtorët çë ishë atié përpara,i dha Iisuit një shplakë e i tha:kështu ti përgjegje kriepriftit? Iisui ju përgjekjë atij: Në u fola kekjë,dëftomë çë thash pér të kekjë; nö pra fola mirë,përcë m'e kërsset?

E Anna dërgoi Iisuin lidhur te Kajafa,Krieprifti. Simon Pietri ishë atié

ORTHROS I TË PRËMPTIES

çë rrrij e ngrohej. Ata shërbëtorë andai i thanë atij: mos edhé ti je një nga dsënësit e 'Tij? Aì e mohoi e tha: U ngë jam; I thot një nga shërbëtoret e kriepriftit, i çili ishë gjëri i atij kuj Pietri i kishë prer veshin: ngë të pash u te kopështi me atë? E pameta Pietri e mohoi e njëiherie gjeli këndoi. E nga Kajafa pra bijën Iisus in te pretorii. Ishë edhé menatnet nji ze e ata ngë hijtën te pretorii mos të ndoheshën, por sa t'hajën Pashkët.

A n t i f o n a e 4.

Σήμερον ὁ Ἰούδας...

Sot Judha lë t'ën'Zonë e lidhet di-allit; lakmia e 'rrygjëndit e verbon; sbier dritën e bie te të errëtitë.

Vërteta si mënd't'shihëj më , pas çë shiti për tridhietë dënarë Dritën?

Po për ne u ngre Aì çë do t'vuanjë për jetën. Atij thomii: O Ti çë vuan me e për njerëzit, paqe lëvdì !

Σήμερον ὁ Ἰούδας παραποւεται

Sot Judha shtihet si i lutëshëm e bënet i huaj i huaj Hirit; tue klënë dsënës, bënet përdhënës. Me siellie miku ai pështron trathëtin. Më se dashurin e t'in'Zoti i patrushmi do tridhietë dënarët tue prijtur Sinedhrin. i të paligjëvet. Po na çë kemi te Krishti shpëtimin Këtë lëvdojëm .

Τὴν φιλαθελφίσν...

Duhemi mirë me dashuri vëllaznore si vëllézër në Krishtin e mos të jemi të thatë përpara të afërmit t'ënë sa mos të jemi dënuar si shërbëtori pa lipisë për haromët e pra mos të pendonemi si Judha pa fituar gjë .

ORTHROS I TË PRËMPTIES

dhoksa ... kje nin ... Δεδοξασμένα *ηχοσα'*

Sa lëvdì u kanë thënë pér Tij gjithë-kund pse Ti Bëresin e gjithësìs e lin-de si njeri, o Mëri Mëma e t'in'Zoti, Virgjérë e përlëvduashme.

Antifona e 5.

'Ο Μαθητὴς τοῦ διδασκάλου...

Dsënësi i Mësuesit pranoi qmimin e me tridhietë tsopa 'rrggjëndi shiti t'ën'Zonë tue ja dhënë me një të putur të rrem të Paligjëvet sa t'e vri-siën .

Σήμερον ἔλεγε...

Sot Bëresi i kjiellit e i dheut i tha dsmësëvet e 'tij:arruri hera:Ju-dha përdhënësi jim ë kötu'. Mosnjeri të më mohonjë kur të më shohënjë te krikjia në mes t'di kusarëve. Do të vuanj si njeri, por ata çë do t'kenë besë tek U , ka t'i shpëtonjë.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

dhoksa;,,kje nin,,, 'H ἀρρήτως...*ηχοστι*. B'

O Virgjérë çë së voni zure në gji e linde Kriuesin t'ënt vet me vier-shë të pathënëshëm, shpëtò ata çë Të madhërojén .

Antifona e 6.

Σήμερον γρηγορεῖ...

Sot Judha rri sgjuar sa të trathëtonjë t'ën'Zonë, Shpëtuesin i jetës më para se jetët të jetëvet, Atë çë me pësë bukë tsiti lusmën. Sot i paligji mohon Mësonjësin; dsënësi trathëton të Zotin; me'rrggjënd shet Kë me mannën ushkjeu njeriun.

Σήμερον τῷ σταυρῷ...

Sot Judha njëzë vun te krikjia t'ënë Zonë, Atë çë me një dru ndajti dejtin e i udhëhekji në shkretirë. Sot me shtizën shpojën brinjën e Atij çë pér ata mundoi Egjiptin me plagë e i dhanë të pij tamëth Atij çë i ushkjeu me mannën .

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Kúrius épi tò páthos tò emouústion

Kur Ti veje me-hir të vuaje i thëshie dsönësëvet:as pér një orë kletë të mirë të rrijët sgjuarë pér mua e më taksët se dej të vdisiët pér mua ?

Shihëni si Judha ngë flë, po përgatitet shpejt të më dorëzonjë të paligjëvet. Ngrëhij , parkalesni sa mosnjéri të më mohonjë si t'më shohënjë mbi krikjien. O lipisiar, lëvdi Tij!

dhoksa ...kje nin... Xaîps Thesot... *htos papos*

T'falemi , o Mëma e t'in'Zoti çë mban në gji të pambajturshmin në kjell.

T'falemi , o Virgjérë, ligjérata e Profetavet me anën e të cilës neve ndriti Emanuili. T'falemi, Mëma e Krishtit Perëndi.

eti kje eti

"Oti sòn tò ipátoç ...

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Çë isht të bëri të trathëtoje Shpëtuesin?mos të largozi nga shokjëria e Apostojvet? mos të ndsori dhuratën e të shëndoshurit?mos si haje me ata të përzuri nga triesa? Mos si i laj këmbët t'jerëvet t'otet i përbuzi? Oh, si i harrove gjithë këto të mira! Mosmirën johësin t'ënde nanë e njohiën gjithë e ligjëronet i papërkrahurshmi durimi i 'Tij e lipisia .

I TRETI VANGJEJ (Mt.XXVI,57-75)

Tek ai kjérò ushtarët, posa çë zun Iisuin,e kjellën te Kajafa,krieprifti, teku shkruesit e plekjtë u kishën mbëjedhurë. Pietri i vej prapa pér së largu njera te trëmeja e kriepriftit: e si hiri brënda mori t'ujej bashkë me shërbëtorët sa t'verrej si sosëj.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Të Parët e priftravet e Plekjët e gjithë ajo mbëledhie kërkojën deshmì, të rreme kundra Iisuit sa t'e vrisiën, e ngë i gjetën.

Edhé megjithë se jerdhën disa deshmitarë të rremë ngë i gjetën: pran u kjasën di të rremë e thanë: "ki ka thënë se " U mëndë të gorromis faltoren e Perëndis e t'e stis te tri ditë".

U ngre Krieprifti e i tha Iisuit: Ti mosgjë përgjegje mbi atë çë këta thënë kundra Tij? E Iisui rrij pa folë. E Krieprifti u përgjekj e i tha:të thérres me be pér Perëndin të gjallë, të na thuashynë Ti je Krishti i Biri i Perëndis. I thot Iisui: ti e ke thënë, po edhé U të thom, se çë nani ka të shihëni të Birin e njeriut ujur tek e dërejta e pushteties s'Perëndis, edhé të vinjë mbi mjekullat e kjielliës. Atë herë Krieprifti shkJORRI pethkat

e 'tija tue thënë: se shtu llastimë: çë e duam më të kemi deshmì? Shi' nani ju e kini gjegjur llastimën. Çë ju duket juve? E ata u përgjegjën: isht ai fajtuar pér vdekjie.

Atëherë i pushtijtën te fakjia e 'tij e i ran me grushte e i dhanë shplaka, tue thënë: Ti,o Krisht, thuajna si Profet, kush t'e kërsiti ? E Pietri rrrij ujur jashta te trëmeja; e ju kjas atij një vajzë tue thënë:edhé Ti ishe bashkë me Iisuin Galileun. Ai e mohoi përra para gjithëve tue thënë: u ngë di çë ti je thua. E si mori të dilëj te derë e pa nj'atër e i tha:atmreve atié: edhé ki ishë bashkë me Iisuin Nazarenin. E ai pameta tue bër be e mohoi: u ngë e njoh atë burrë.

Mbi tsa pak ata përrpara u kjasën e i thanë Pietrit: vërteta edhé ti je një

nga ata:se edhé të folët t'at të bën
të njihrsh. Ahierna zu ai të némëj,
të bëj be e rrëfë:se u ngë e njoh atë
njeri. E te gjithë një herë gjeli kën-
doi. E u kujtua ahierna Pietri nga fi-
ama e Iisuit, çë i kishë thënë:se më
para se të këndonjë gjeli, ti mua tri
herë ka t'më mohosh. E dolli jashta e
klajti me helm.

Lëvdì v.f. 230

A n t i f o n a e 7.

Toῖς συλλαβοῦσι Σε παρανόμοις

Të paligjëvet çë të vun duart sipër
me durim po thoshie: në ju kësitët
Delmerin e shprishët dimbëdhietë de-
let, dsënësit t'imë, U mënd't'kisha t
therriturmë shumë se dimbëdhietë Le-
gjonë ëngjëjish të ndodheshën këtu'.

246.

Po jam zëmëmathë sa t'mbaronet çëdò
i panjohur e i fshehët U ju kisha sbë-
luar me gojën e Profet travet. O i Ma-
dh'in'Zot, paçe lëvdì!

Τρίτον ἀρνησάμενος ...

Posa të mohoi tri herë Pietri u kuj-
tua njëiherie nga atë çë i kiske thë-
në e të fali lotë pendimi. Ijëmë afër,
o Perëndì, e shpëtomë.

dhoksa...kje nin... 'Ως πύλην... *γκοστή*

HImnojëm të gjithë shejten Virgjérë që
isht dera e shpëtimit, parraisi i gëzi-
mevet, reja e drités s'pasosme. Tho-
mii : gëzou !

A n t i f o n a e 8.

Εἴπατε παράνομοι...

Thoni, o ju të paligjë, çë gjegjët ju
nga Shpëtuesi jinë:ngë na shpalli Aï
Ligjën e mësimet e profet travet ? Si
atëherë menduat të ja jipiët te due
art Pilatit Fialën e Perëndis e Shpë-
tuesin e shpirtravet t'anë?

247.

Σταυρωθήτω ζυραζον ...
 Le t'jet vënë ngrikjë ! lurijën ata
 çë gjithëmonë u kishën ushkjier me
 dhuretít t'ote. Vrasësit e të dërejë
 tëvet lipiën të jet lënë i lir ,në
 vend të Mirëbëresit,një katil.

Ti rríje pa folë tue duruar të pa-
 kjëndruashmit e 'tire përgë deje të
 vuaje e të na shpëtoje.

dhoksa...kje nin..."Oti oύν ᷂χομεν...

Posa ngë kemi kudsim pér të shumëtat
 mëkatë t'ona,vuru pér në mes Ti tek
 Aì çë leu ngah Ti,o Virgjérë Mëmë e
 t'in'Zoti. Shumë mëndë parkalesia e
 njëi mëmie sa t'sbutsonjë të Zotin.
 Mos përbuz lutiet e të mëkatruamëvet,
 o gjith'e ponisëshme,pse kush me-hir
 deshi të duroj te kurmi i 'tij pér ne
 isht lipisiar e mëndë të shpëtonjë .

Hxos β'

A n t i f o n a e 9.

"Εστησαν τὰ τριάνοντα...

I paçmuashmì kle çmuar tridhietë dë-
 narë nga të bijët e Israelit.

Rrini sgjuarë e parkalesni mos bini
 në ngarie;shpirti isht gati,po mishët
 ë të dobët:prandai rrini sgjuarë.

Ms.68,22 "Ἐδωκαν εἰς τὸ βρῶμα...

E më dhanë pér të ngrënë tamëth e të
 pija më dhanë uthullë.

Ms.40,11. Po Ti,i Madh'in'Zot,kijmë
 lipisi e ngrëjëmë;ata do 'ti shpaguanj
 U.

dhoksa...kje nin ... Oi èz èthvñv...

Hxos

Na nga gjithë kombet të himnojëm,o
 Möma e dëlirë e t'in'Zoti,se na linde
 Krishtin Perëndin t'ënë,Atë çë paj
 tënt na liroi neve njerëzë nga mahki-
 mi.

Êti naî Êti...

"Iva σεσωσμένοι φυχῇ τε ήαὶ σώματι πάντοτε διαμένοντες, μετὰ παρθησίας δοξάζωμεν τὸ θαυμαστὸν ήαὶ εύλογημένον ὄνομα σοῦ τοῦ Πατρός..."

naθ. "Ω πῶς 'Ιούδας..."

Oh, si Judha, më para dsënës jiti, mejmëjton kundra Teje trathëtin !?

Bëri darkë bashkë me Tij me gënjinimo i kekjëdashësi e i prapi-e pran shkoi e i tha priftravet: çë më jipëni e u ju dorzonj Atë çë shtipi Ligjën e dhunoi Faltoren? O Zot i zëmërëmath, paçë lëvdì.

I KATERTI VANGJEJ

(Jani 18,28-19,16)

Tek ai kjérò ata bijën Iisuin te Pretorii: ishë edhé menatnet njize e ata ngë deshën të hijën te Pretorii mos të ndoheshën, sa t'hajën Pashkët.

Pilati andai dolli jashta tek ata e

250.

i tha atireve:mbë çë ju do t'e ngale-snë këtë njeri? Ju përgjegjën e i thanë atij: në mos ishë një çë bën të kekjë, na ngë t'e kishëm prur përpara.

Ahierna Pilati i tha atireve:mirrnie e gjikoni me Ligjën t'ëjë. Por Ju-dhénjtë i thanë atij: na ngë mëndë të vrasiëm njeri. Sa të mbaronej fiala e Iisuit çë tha tue dëftuar me cilë vdekjie kishë Aì të vdisëj.

Andai hiri pameta te pretorii Pilati e thërriti Iisuin e i tha: Ti je Rregjji i Judhénjëvet? Ju përgjekj atij Iisui: ngak ti thua këtë a t'e thanë të t'jerë për Mua? Pilati ju përgjekj: mos jam u Judhë? Gjindia jote e të Parët e priftravet të lanë te duart t'i-me: Ti çë ke bër? Ju përgjekj Iisui: rregjëria jime ngë isht nga këjò jetë: në ishë nga këjo jetë rregjëria jime, shërbëtorët t'imë ki't'zëheshën sa

ORTHROS I TË PRËMPTIES

mos t'isha dhënë te duart e Judhénjëvet:po rregjëria jime ngë isht këndeje.

Andai i tha Pilati:kështu rrekj je Ti? U përgjekj Iisui:Ti vete thua se.U jam rrekj:prandai U u leva jer-dha tejeta,sa të bënë deshmì të Vërtetës. Nga-një çë isht nga ana e të Vërtetës,gjegjet zërin t'im.

I thot Pilata:çë isht e Vërteta?

E tue thënë kështu dolli pameta ja-shta te Judhénjtë e i tha atire: U ngë gjenj tek Aì ndo-një faj.

Isht zakonë tek ju se ju lëronj një te Pashkët:doni andai se t'ju lironj Rregjin e Judhenjvet? Por ata zun të lurijën pameta të gjithë:jo këtë,po lërena Barabën: sihë Baraba një kusar.

Atë herë mori Pilati e mënd'e dërsë-lluan. E ushtarët pleksën me glëmba një kurorë e ja vun mbi krijet,e i shtun ngrah një të veshurë të kukje e i thoshiën:T'falemi,o Rregji i Judhénjëvet,

252.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

e i jipiën shplaka.

Dolli pra Pilati pameta jashta e i tha atire: shi'ju e bie jashta sa t'e dini se tek Aì u ngë gjenj ndo-një faj. Andai Iisui dolli jashta,tue pa-sur kurorën glëmbash e mëndillin të kukjë ngrah. E Pilati i tha atireve: SHI' NJERIU !

Por si a pan të Parët e priftravet e shërbëtorët zun të ulurijën tue thënë: vure ngrikj Atë. I thot Pilati: mirrnie ju e vërnje ju ngrikj: u ngë gjenj tek Aì faj. Ju përgjegjën atij Judhénjtë: na kemi një Ligjë;e me ligjën t'ënë Aì ka të vdesënë;se Aì bë vetëhén Bir i Perëndis.

E kur gjegji Pilati këta të folë më shumë u trëmp. E hiri te pretorii pameta e i tha Iisuit:ngaha je Ti? Iisui ngë i dha atij përgjegje.

Andai i thot Pilati:mua ngë më flet? Ngë di Ti se u kam pushtetie të të lë të vetsh?

253.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

U përgjekj Iisui:ngë mëndë të kishe pushtetie mbi Mia, në mos ngë t'u kishë dhënë 'n së larti. Andai ai çë më dha te duart t'ote ka mëkatë më të madhe. Çë ahierna Pilati kërkoj t'e lëj të vej. Po Judhénjtë po lurijen tue thënë:në ti lë këtë të ve, ti ngë je mik i Çesarit. Kush bën rrekjë vetëhén e 'tij, ai vete kundra Çesarit.

Prandai Pilati, të gjegjurit këta të folë muar e kjelli jashta Iisuin e u vu t'ujej mbi thronin te vendi çë i thonë lithostrotos, çë ebraisht thonë gavathà .

E ishë e Prëmptia e Pashkëvet, si e gjashta orë, e i thot Judhenjvet: shi' rregji i jij .

E u vun të lurijën:ndësire, ndësire, vu-re ngrikjë. I thot atire Pilati: rre-gjin t'ëj ka t'vë ngrikjë ? U përgje-

ORTHROS I TË PRËMPTIES

gjën kriepriftrat: na ngë kemi t'jatër rrekjë më se Çesarin.

E ahierna mori e ja dha atire te duart sa t'e vëjën ngrikjë.

Lëvdì

A n t i f o n a e 10.

'O ἀναβαλλόμενος φῶς...

Ai çë vishet me drítë si me një mënt parakjitet milikurë te gjikatoria e nga duar çë Ai vet bëri merr shplaka te fakjia. Një popull i paligjë vë në krikjë Rregjin e lëvdis. Ahierna u shkjuarr ndish villi i Faltore; dielli u err sa mos të shihëj shajtur Perëndin përpara t'çilit gjithkjish dridhet; Atë le t'proskjinisiëm.

'O μαθητὴς...

Dsënësi mohon, kusari thërrret: kujtomë, o Zot, te rregjëria jote.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

dhoksa...kje nin... Eipñveudov... *γιαστης*

Jip pakjien jetës,o i Madh'in'Zot,
Ti çë pranove të visheshe me mishë
nga Virgjëra pér shendetën e shërbë-
torëvet t'atë sa na gjithë një zë të
t'japiëm lëvdì Tij, o Mik i njeriut.

A n t i f o n a e 11.

'Avri ëyaxthwv...

Në vend të të miravet çë i bëre,o
Krisht,farës e Israelit, ata të vun
në krikjë e të bën të pije uthuhë e
tamëth. O i Madh'in'Zo,mos i paguaj
si i nget të bëmavet e 'tire,pse ngë
ndëlguan të përunjurit t'atë.

'Epi tñ προδοσία...

Ngë u tsitën Judhénjtë me trathëtin;
të tundurit krei i shtuan edhé të sha-
ra e të kjeshura. Po Ti , o Zot , se
ata mejtuan kotësira kundra Teje,mos
i paguaj pas vepravet e 'tire .

ORTHROS I TË PRËMPTIES

Oürte γῆ ὡς ἐσείσθη ...

As kur dheu u shkunt , as kur gurët
u çajtën, u bindën të bijët e Israe-
lit,as kur u shkjuarr villi i Falto-
res,as kur të vdekurit u ngjallën.

Po Ti,o Zot,se ata mejtuan kotësira
kundra Teje, mos i paguaj pas vepra-
vet e'otire .

dhoksa...kje nin... Θεὸν ἐν σοῦ... *γιαστης*

E njohëm Perëndin çë mori kurm ngah
Ti , o Mëma e 'tin'Zoti Virgjereshe ,
e vetmia e bekuame,e vetmia e dëlirë.

Andai pa pushim tu të kënduar të ma-
dhërojëm.

A n t i f o n a e 12.

Táðe λέγετ Kúrioc...

O populli jim,çë të bëra,thot in'Zot,
ambi çë të helmova? Të verbërëvet
t'atë i dhash dritën,pastrova të ger-
bulët,njeriun shtur te shtrati t'e
ngrëjta. O populli jim,çë të kam bër,

ORTHROS I TË PRËMPTIES

çë më paguan kështu? Në vend të man-nës më jep tamëth; në vend uji, më jep uthullë; në vend të më duash mirë, më vu ngrikjë. Ngë dua më të tju jem peshtrimi: dua të thérres kombet e ataka t'më lëvdojën me Atin e me Shpir-tin e U dua t'i jap atireve gjellën e pasosme.

Σήμερον τοῦ Ναοῦ ...

Sot villi i Faltores tue u shkjier-rë kjérton të paligjët, e dielli fsheh rrëmpat e 'tij, tue par t'en' Zonë vënë ngrikjë.

Oi vnuoθétau τοῦ Φοαήλ...

Kori i Apostojvet i thot sot ligjëtarëvet e Israelit: o judhenjë e farisenjë, vërreni faltoren çë ju prishët, vërreni kjenkjin çë ju krikjëzuat.

E vut te varri, po Aì me pushtetin e 'tij u ngre. Mos gënjenij, o Judhénjë: isht Aì çë ju shpëtoi te dejti e çë ju ushkjeu në shkretirë. Aì isht gjella, Aì drita e pakjia e jetës.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

dhoksa... kje nin, : Xañpe ë púlq... *Hxos q'g'*

T'falemi, o dera e Rregjit pér të ci-lén i Larti vetëm shkoi tue e lénë të vulosurë pér shëndetën e shpirtravet t'anë.

eti kje eti

"Οτι σὺ εἶ ὁ Θεὸς ἡμῶν, ναὶ σοὶ τὴν δόξαν ἀναπέμπομεν

καθισμα "Οτε παρέστης τῷ Καΐόφα

Kur, o i Madh'i'mn'Zot, u parakjite Kajafës e Ti, Gjikëtari, klve dorë-zuar Pilatit, fukjít e kjielliavet nga frika zun të dridheshën. Ahierna Ti klve ngrëjtur mbi Drurin në mes di kusarëve e Ti i pafajshmi klve ném-ruar ndër te kekjité sa t'shpëtoje njeriun. O Zot i duruashëm, paçe lëv-di !

ORTHROS I TË PRËMPTIES

I PESËTI VANGJEJ (Mt.27,3-32)

Tek ai kjérò kur pa Judha se Iisui kle gjikuar pér mortë, u pendua e mori tridhietitë dënare të 'rrgjendë e ja prori kriepriftravet edhé Plekjëvet, tue thënë: U mëkatrova, se ju dhash te duart gjak të pafajshëm. Por ata i tha-në: çë e duam na? ti ka t'e vërrresh.

E aì shturi atié te faltoria të 'rrgjendit e jiku e vate u vuar. Kriepriftrat pran muartin atë dënare të 'rrgjend e thanë: ngë isht drekjë se kë-ta-t'i vëm te tesori i Faltores, se janë çmim gjaku. E ata mbajtën këshill e blen me atë dënare dheun e shtëmba-rit pér të varrzuarit të huajit. Andai kle thërritur ai dhe "dhe gjaku" njera më nanì. Ahierna u mbarua e thëna e Profetit Jeremì çë thot:"e

ORTHROS I TË PRËMPTIES

muartin tridhietit dënare të 'rrgjendë, çmimin e të çmuamit, të atij çë kle çmuar nga të bijët e Israelit e ja dhanë të blijen dheun e atij çë bën kjeramidhe, ashtu' si, më kishë urdhuruar in'Zot.

E Iisui u ndoth pérpara Kreut e vendit e Kreu i piejti tue thënë: Ti je rregji i Judhénjëvet? E Iisui i tha atij: Ti vet e thua. E kur e ngalesiën të Parët e priftravet edhé Plekjët, Aì ngë i përgjegjej gjë fare. Ahierna i thot atij Pilati: ngë gjegje Ti sa deshmojën kundra Teje? E atij ngë u përgjekjë te mosnjera fialë, akjë se i Pari famasej fort. Pér ditën e kremlties kishë zakonë Kreu i vendit t'i lëshoj gjindes një të lidhur, kë dejën ata.

E kishën ahierna një të lidhur të njo-hur, çë i thoshiën Baraba. E kur ata ishën atié bahkëmbëjédhurë, Pilati i

tha atire:kë doni ju të ju lëshonj?
 Barabën o Iisuin çë thoni Krisht ?
 Se dij se ja kishën dhënë te duart
 pér smir. E si rrij ujur mbi thronin
 e Ligjës i dërgoi të thënë gruaja e
 'tij: mosgjë të kesh ti me atë të Dë-
 réjt, se sot pér atë u reva shumë te
 èndërra. E të Parët e priftravet e
 Plekjët shtijtën gjindet të lipiën
 Barabën e Iisuin t'e vrisiën.

Ju përgjkjë pra Pilati e i tha ati-
 reve:çilin doni ju t'ju lë nga të di?

E ata i thanë :Barabën. I thot atire
 Pilati: e çë ka t'e bënje Iisuin çë
 thonë Krisht ? I thonë atij të gjithë:
 le t've ngrikjë! I thot atireve kji-
 vertari:se që të kekjë ka bër Aì? E
 ata më shumë po lurijën tue thënë:le
 t've ngrikjë. E të parit Pilati se
 ng'e ndihëj e se po bënej trazim, mo-
 tsia ujë e lajti duart pérpara gjindes
 tue thënë: U jam pa faj të gjaku i kë-

tij të Dërejti:ka t'e vërreni ju.
 E gjithë populli ju përgjekjë e i
 tha:gjaku i'tij mbi ne e mbi bijët
 t'anë. Ahierna i lëshoi atire Bara-
 bën, e Iisuin, posa çë bë t'e dërsëlllo-
 jën, ja dha te duart sa t'ishë vënë
 ngrikjë.

Ahierna ushtarët e kjivertarit si e
 muartin Iisuin e e prun te pretorii,
 u mbëjodhën gjithë shokët nd'anëzë
 atij. E posa e dëgeshën, i vunë ngrahë
 një mëndil të kukjë e pleksurë një
 kurorë glëmbash ja vun mbi krie e një
 kallëm te dore e dërejtë e 'tija.

E tue pushtijtur mbi Atë, i mirriën
 kallmin e ja kërsisiën te kriet. E
 posa çë e patën kjeshuar, i ndsuatën
 atë mandil, e veshën me të veshurat
 e 'tija e e kjellën t'e vëjën ngrikjë.

E si ish'e diliën, gjetën një njeri
 kjiriné, pér emër Simon:këtë e shtrën-
 guan të nglakoj krikjien e 'Tij.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

A n t i f o n a e 13.

Mbledhia e Judhenjëvet i lipi

Pilatit të të vëj ngrikjë, o i Madhi
in'Zot. Po posa ngë gjetën faj tek Ti,
liruan atë çë kish'të përgjegjej pér
disa faje, Barabbën e Tij të Déréjti n
të dënuan tue trazhguar përgjegjësin
e kësaj vrasie. Po Ti, o i Madh'in'Zot,
jipi atire të ndëlgojën se mejtuan ko
tësira kundra Teje.

*Ov πάντα φρίσσει...

Atij përpara t'çilit gjithë kriesa
trëmbet e dridhet, Atij çë çëdò gluhe
lëvdòn, Krishtit, Fukjia e Perëndis e
Dieja, priftrat i dhanë shplaka e i
dhanë të pij tamëth. E Aì deshi të du
roj gjithkujshë sa t'na shpëtoj me gja
kun e 'tij nga mëkatët t'ona, pse na do
mirë. Hxos πτ. 1
dhoksa... kje nin ... Θεοτόκε ή τει..

O Mëma e t'in'Zoti, çë tue marrë Fia
lën, pa na ndëlguar si, linde Krionjë
sin vet, lutu të shpëtonjë shpirtrat
t'anë.

264.

ORTHROS I TË PRËMPTIES

A n t i f o n a e 14.

Kúriε, δ τὸν ληστὴν...

O i Madh'in'Zot, more pér shok-dhromi
kusarin me duart të liejtura me gjak.

Vën-na bashkë me atë se Ti je i mirë
e na do mirë.

Μιμρὰν φωνὴν ...

Ndsori një zë të vogël, po e madhe
kle besa e 'tij. Në një qast u shpë-
tua e i pari sbilli derën e hiri në
Parrais. O Ti çë prite mirë pendimin
e 'tij, paqe lëvdi!

δόξα... μαὶ νῦν. Χαῖρε ή ... Hxos πτ. 2

Gëzou, o Ti çë me anën e Ëngjëllit
prite mirë harën e jetës.

Gëzou Ti çë linde Bëresin e të Zotin
t'ënt.

Gëzou Ti çë kleve bër e mirë t'bëne-
she Mëma e Krishtit Perëndi.